



Universiteit
Leiden
The Netherlands

Security as a social construction: insecurity as a condition for security

Macaj, G.

Citation

Macaj, G. (2006). Security as a social construction: insecurity as a condition for security. *Anash-Approaching Science*, 1(2), 21-27. Retrieved from <https://hdl.handle.net/1887/4307111>

Version: Publisher's Version

License: [Leiden University Non-exclusive license](#)

Downloaded from: <https://hdl.handle.net/1887/4307111>

Note: To cite this publication please use the final published version (if applicable).

ANASH

APPROACHING SCIENCE

ANALET

E ALB-SHKENCES


VITI I • NUMRI 2 • DHJETOR 2006

BOTIM I INSTITUTIT ALB-SHKENCA
www.alb-shkenca.org

Kosova prioritet panshqiptar
SAMI REPISHTI

Zef Skiroi dhe shkrimet shqip
BARDHYL DEMIRAJ

**Zhvillimi i sektorit të bimëve
mjekësore në zonat rurale**
KOZMA NAKA
BAHRI MUSABELLIU



PROLOG

Botimi i një reviste informativo-shkencore shiptare u bë i domosdoshëm në kushtet në të cilat ndodhet dhe zhvillohet sot shkencë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni dhe në një kohë kur numri i anëtarëve të Forumit Alb-Shkenca (<http://www.alb-net.com/mailman/listinfo/alb-shkenca>) ka arritur një numër të madh pjestarësh. Shumica e këtyre anëtarëve janë studiues, pedagogë e studentë pasuniversitarë shqiptarë që kryejnë veprimtarinë e tyre shkencor në vende të ndryshëm të botës. Por ka edhe shumë anëtarë të Alb-Shkencës që kontribuojnë në gjallërimin e jetës shkencore në universitetet dhe institucionet shkencore në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Revista e Alb-Shkencës synon të bëjë të njohur në të gjithë botën shqiptare aktivitetin shkencor mjaft të larmishëm dhe shpesh herë shumë cilësor, të studiuesve shqiptarë kudo që ndodhen në botë. Nëpërmjet përzgjedhjes së kujdesshme të shkrimeve, në këtë revistë kemi pranuar për botim vetëm ato shkrime që kalojnë në nanofiltrin e cilësisë. Këtu pra do të pasqyrohet ajo ç'ka është më e shquara e kontributit shkencor shqiptar në këto vite të para të shekullit XXI.

Kjo revistë e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse, botim i Institutit Alb-Shkenca (www.alb-shkenca.org) që u krijua këtë vit, është menduar t'i shërbejë një auditori të gjerë intelektualësh e dashamirësish të shkencës në përgjithësi dhe të shkencës shqiptare në veçanti. Anëtarët aktualë të Institutit vendosën ta quanin këtë revistë me emrin simbolik: ANASH—Approaching Science.

Dikush mund të pyesë: Përse emri ANASH? Ai është akronim i emrit “Analet e Alb-Shkencës” që është edhe emri zyrtar i kësaj reviste. Por fjala shqip “anash” merr një kuptim simbolik fare të veçantë kur vendoset përpara shprehjes në anglisht “Approaching Science”.

Fjala “anash” ka edhe një kuptim të dytë simbolik që reflekton të vërtetën, atë që diaspora intelektuale e shkencore shqiptare është lënë pakëz mënjane nga vëmendja e politikëbërësve dhe pushtetarëve shqiptarë e ndoshta edhe është harruar për shkak të largësisë e kohës nga trojet e atdheut.

Por e vërteta është që edhe pse ndodhen larg, anash realitetit të përditshëm të shqiptarëve të Ballkanit, intelektualët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë atdheut shërbejnë jo vetëm si ambasadorë të shkëlqyer por vëzhgojnë e ndjekin nga afër ecuritë në çdo fushë të jetës dhe shoqërisë shqiptare. Të organizuar tek Alb-Shkenca ata gjithmonë e më shumë po kërkojnë të marrin pjesë aktivisht dhe të ndihmojnë për një jetë më të mirë të shqiptarëve kudo që ndodhen. Botimi i revistës ANASH është shprehje e qartë e këtij angazhimi serioz të diasporës shkencore që po përpaket përditë e më tepër të kontribuojë në zhvillimet jo vetëm të shkencës dhe arsimit por edhe të shoqërisë shqiptare në përgjithësi.

Revista ANASH-it do të përfshijë një larmi artikujsh prej fushave nga më të ndryshmet shkencore të përgatitur nga studiues të afirmuar apo studentë pasuniversitarë shqiptarë që kontribuojnë në shkencën botërore edhe në disiplina shkencore nga më të rejtat si nanoteknologjia, ekologjia dhe informatika, por edhe në fushat klasike të shkencës si fizika, veterinaria, ekonomia dhe gjuhësia (albanologjia).

Ju urojmë të gjithëve lexim të këndshëm.

REDAKTOR SHKENCOR: **Nikolla P. Qafoku**, PhD, Shtetet e Bashkuara të Amerikës

REDAKTOR PËRÇJECJËS: **Roland Leli**, Kanada

ADMINISTRATORE E PËRGJITHSHME: **Lindita Komani**, Austri



KUJTESE PËR SHKRIMET DHE AUTORET NË “ANASH”

Instituti “Alb-Shkenca” ka filluar botimin e revistës shkencore ANASH—Approaching Science (Analet e Alb-Shkencës). Në këtë revistë kryesisht botohen: i) raporte shkencore; ii) komente; iii) perspektiva; iv) prezantime apo përmbledhje diskutimesh në konferenca; v) letra që mund t'i dërgohen botuesit të Analeve. Botohen gjithashtu edhe shkrime të cilat mbështeten apo marrin ide nga diskutimet që bëhen në Forumin tonë “Alb-Shkenca”.

i) Raportet shkencore përmbajnë rezultate origjinale të punës shkencore të autorit apo autorëve. Duhet të jenë 4-5 faqe të gjata përfshirë këtu figurat dhe referencat bibliografike.

ii) Komentet mund të shkruhen për artikuj të një rëndësie të veçantë në një degë përkatëse shkencore apo edhe për libra shkencorë. Komentet duhet të jenë jo më të gjatë se 3 faqe.

iii) Perspektivat paraqesin ide rreth kërkimit shkencor në fusha të veçanta studimi. Ato duhet të jenë 1-3 faqe të gjata.

iv) Prezantimet në konferenca mund të paraqiten si përmbledhje të rezultateve dhe rekomandimeve më kryesore, ku mund të përfshihen jo më tepër se 1-2 figura. Prezantimet duhet të jenë 1-2 faqe të gjatë.

v) Letrat për botuesin duhet të jenë të gjata 1-1,5 faqe dhe do të trajtojnë probleme nga më të ndryshmet që kanë të bëjnë me kërkimin shkencor.

ANASH është një revistë e përgjithshme shkencore me një auditor të gjerë lexuesish që i takojnë fushave të ndryshme. Për këtë arsye, dorëshkrimet që do të dërgohen për botim duhet të jenë të kuptueshme për këtë auditor të gjerë. Të paktën njëri prej autorëve duhet të jetë anëtar i Institutit “Alb-Shkenca”. Dorëshkrimet do të pranohen në shqip dhe anglisht në adresën: anash@alb-shkenca.org ose analet@alb-shkenca.org. Ato duhet të shtypen në “word” me hapësirë dyfish ndërmjet rreshtave si dhe me madhësi gërmash 11 pt.

Pasi merren në redaksi, dorëshkrimet u dërgohen recensuesve. Çdo dorëshkrim lexohet nga 1-2 të tillë ku njëri prej të cilëve është anëtar i Institutit “Alb-Shkenca”. Procesi është “double-blinded”, i tillë që recensuesit nuk dinë emrin apo emrat e autorëve, dhe po ashtu, autorët nuk dinë emrat e recensuesve. Dorëshkrimi do t'i kthehet mbrapsht autorit për të reflektuar vërejtjet e rastit e autori do të duhet të ridërgojë në redaksi dorëshkrimin e korrigjuar pas një periudhe jo më të gjatë se 2 javë nga dita që e ka marrë nga redaksia. Çdo komunikim ndërmjet redaksisë, autorëve dhe recensuesve do të bëhet elektronikisht. Këtij procesi nuk do t'i nënshtrohen dorëshkrimet, të cilët u kërkojnë autorëve nga Këshilli Botues i revistës. Në këtë rast, njëri prej anëtarëve të Këshillit Botues do ta lexojë dorëshkrimin dhe do t'i dërgojë vërejtjet autorit.

Revista fillimisht do të dalë dy herë në vit dhe do të botohet në formë elektronike si dhe në CD-ROM. Ajo do të mund të lexohet në faqen e Institutit “Alb-Shkenca” në internet në adresën www.alb-shkenca.org. Për mundësinë e shtypjes së saj dhe për çmimin do të vendoset në vijim.

Pyetjet dhe sugjerimet tuaja mund t'i drejtoni në adresën anash@alb-shkenca.org ose analet@alb-shkenca.org.

Redaksia e Revistës ANASH - Approaching Science

© COPYRIGHT I INSTITUTIT ALB-SHKENCA
ÇDO MATERIAL I KESAJ REVISTE MBROHET NGA E DREJTA E AUORIT

PASQYRA E LENDES

Editorial: 2007- Kosova prioritet panshqiptar	SAMI REPISHTI	4
Zef Skiroi (prosenior) dhe shkrimet e tij shqip drejtuar Papës Benedikti XIV	BARDHYL DEMIRAJ	7
Arapë dhe shqiptarë	ARDIAN VEHBUI	15
Nils Eldredge: Të shpëtojmë planetin nga katastrofa njerëzore		18
Këndi i librit: “Dhjetë fytyrat e inovacionit”		20
Siguria si konstruksion shoqëror: pasiguria si kusht i domosdoshëm për sigurinë.....	GJOVALIN MACAJ	21
Zhvillimi i sektorit të bimëve mjekësore si alternativë për rritjen e të ardhurave plotësuese në zonat rurale	KOZMA NAKA, BAHRI MUSABELLIU	27
Carlo Tagliavini dhe albanologjia.....	ELTON K. PRIFTI	35
Këshilla për lexim		38
Muhammad Yunus, bankieri i të varfërve		39
Vaso Čubrilović: The Expulsion of the Albanians: Memorandum 1937	ROBERT ELSIE	41
The End of History and the Last Province.....	FATOS TARIFA, PETER LUCAS	53
History of Programming Paradigms – History of Increasing the Level of Abstraction.....	PETRAQ PAPAJOGE	61
Këndi zbavitës		66
Jeta në Alb-Shkenca		67

2007:

KOSOVA PRIORITET PËN SHQIPTAR

Prof. Sami Repishti

*"Standard nr. 6: Trashëgimia e Kosovës respektohet si pasuni e të gjithë bashkësive etnike, fetare dhe linguistike të saj." (UN Standards for Kosovo/a)**

Zhvillimet e shpejta (shpesh herë zhgënjyese) të ngjarjeve në dhe rreth Kosovës tregojnë se një epokë e re, me përpjestime të mëdha historike për kombin shqiptar, po shpaloset në atë krahinë shqiptare të martizuar. Kosova, me hapa të ngadaltë por të sigurtë po fiton pavarësinë e mohuar padrejtësisht më 1912, 1918, dhe më 1944-45. Është opinioni i përgjithshëm se akti vendimtar i konsakruar nga bashkësia ndërkombëtare nëpërmjet një rezolute të OKB-së për Kosovën do ta nxjerrë përfundimisht atë jashtë kuadrit serb dhe do të hedhë bazat ligjore për pavarësi të njohur ndërkombëtarisht.

Një proces me një domethënie kaq thelbësore ka dinamiken e vet, si dhe një lëvizje të motivuar nga imperativi kategorik i vënies në vend të një padrejtësie që zgjati më shumë se një shekull, dhe të një agresioni gjenocidal serb. Dinamika e re kërkon një kuptim më të plotë të historisë së kaluar dhe të së tashmes së Kosovës, si dhe marrjen parasysh të marshit të pandalshëm drejt pavarësisë, gjë që u shfaq me rezistencën kosovare – paqësore dhe të armatosur – e cila arriti kulmin me ndërhyrjen e NATO-s në mars-qershor 1999.

Kosova nxori në shesh nevojën e shqyrtimit të ligjit ndërkombëtar, si dhe të kombinimit të së drejtës ndërkombëtare e të së drejtave të njeriut, si epiqendër. Koncepti post-modernist i përqendrimit të vëmendjes sonë kryesisht tek NJERIU dhe jo vetëm tek SHTETI, kërkon nga ne që para së gjithash të pyesim çfarë kërkon sot Kosova dhe çka don sot populli kosovar? Pa dashur të kufizoj përgjigjen e këtyre pyetjeve ekzistenciale për Kosovën, mund të përsërisim bashkë me autoren e njohur Anna De Lellio, se Kosova kërkon:

– Eliminimin e të gjitha pengesave për një zhvillim të plotë e të gjithanshëm, kryesisht pengesat që krijojnë frikë për banorët e asaj krahine (sot shteti kosovar); dhe,

– Një integrim, jo ndarje dhe izolim, më të plotë dhe më të mirë se ai që propozon bashkësia ndërkombëtare, si dhe respektin e plotë të të gjitha bashkësive të Kosovës, sidomos të pakicave etnike e fetare dhe grupeve linguistike. Kosovarët kanë të drejtë të friksohen nga ndarjet administrative që më vonë mund të përdoren si instrumente dhe si baza për reklamime me karakter territorial në kurriz të Kosovës.

Dinamika e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë (1999), që fillon mbasi forcat serbe, ushtarake, policore dhe paramilitare, vranë më shumë se 12.000 shqiptarë, therren gjysmën e bagetive, shkatërruan një të tretën e banesave dhe grabitën të tjerat, kthyen qendrat urbane të Pejës, Gjakovës dhe Mitrovicës në grumbuj gërmadhash, shkatërruan me eksploziv ose me zjarr më shumë se 200 xhami dhe qendra kulturi, dhunuan më shumë se 20.000 gra shqiptare (sipas Qendrës për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve në Kosovë), dëbuan rreth një milion refugjatë që u strehuan kryesisht në Shqipëri, Maqedoni e Mal të Zi, ka përmbysur përfundimisht status quo-në para 1999-ës dhe ka hapur perspektiva të reja me frymë europiane. *"Për shqiptarët e Kosovës, – shkruan De Lellio, – të gjitha këto humbje ishin gjaku që duhej paguar për pavarësi!"* Sot, bota e qytetëruar pyet: Përse?

Kthimi në të kaluarën është i pakonceptueshëm, ashtu siç është edhe mbajtja e gjendjes në limbo. Problemi i Kosovës kërkon një zgjidhje të re, të drejtë dhe të shpejtë, dhe kjo është pavarësia!

Një nga pengesat kryesore për të cilat flet De Lellio është qendrimi i qeveritarëve serbë në Beograd dhe i elementeve shoviniste serbe në Kosovë, qëndrim që nuk ka pësuar asnjë ndryshim nga ai i Millosheviçit të para luftës. Kohët e fundit, parlamenti serb aprovoi një kushtetutë të re për Serbinë, ku theksohet se "Kosova është pjesë integrale e Serbisë". Për fat të keq, ky orientim politik sa i gabuar aq edhe i rrezikshëm për krahet

fuqimisht nga dy shtyllat e shovinizmit serb: Kisha ortodokse Serbe dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë (e njohur si Francuzka 7), *Kronikat* dhe *Memorandumet* e tyre respektive.

Një qëndrim i këtillë është mjaft shqetësues. Historia tregon qartë se të gjithë agresionet serbe kundër territoreve përfaqësojnë Serbisë janë paraprirë dhe përgatitur nga klerikë ortodoksë dhe arsimtarë serbë. Agjensitë e lajmeve, vendase dhe ndërkombëtare, raportojnë vazhdimisht deklaratat e bëra nga klerikë të lartë serbë, rusë dhe grekë (disa herë edhe rumunë e bullgarë). Epiqendra e akuzave të tyre është "përpykja e pandërprerë e shqiptarëve të Kosovës për të dëmtuar ose shkatërruar trashëgiminë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë". Patriarku serb Pavle dhe homonimi i tij rus, Alexy II-të, alarmojnë vazhdimisht "botën e krishterë" mbi rrezikun iminent dhe vdekjeprurës që kërcënon Europën, bile edhe mbarë botën, që mund të vijë nga një Kosovë "shtet islam" i lirë dhe i pavarur.

Ky argument u përpunua nga peshkopi serb Artemije, i Rashkës dhe Prizrenit, gjatë vizitave të tij në Washington D.C. vitin e kaluar, të përkrahura nga lobi "Serbian National Union" që kryesohet nga ish-koloneli greko-amerikan J. Jatrass. Akuzat e peshkopit ishin aq të ekzagjeruara sa që ambasadori serb në Washington Ivan Vujavich, u detyrua të kërkojë falje për deklaratat raciste dhe tonin anti-islam të mesazheve të "Serbian National Union". Shqetësimi ynë është edhe më i madh kur krahasojmë tonin dhe përmbajtjen e mesazheve serbe me ata të para agresionit serb në Kroaci dhe Bosnjë më 1991-92.

Në një përgjigje të dhënë nga prelati shqiptar i Kishës Katolike të Kosovës, at Lush Gjergji thuhet: "... Shqiptarët e quajnë krishtërimin si një trashëgim i tyre, shpirtëror dhe kulturor, megjithëse për traditë ose për bindje shumica janë myslimanë. Krishtërimi është kyçi i vetënjohjes dhe i historisë sonë 2000 vjeçare, se cilët kemi qenë, cilët jemi sot dhe cilët duam të jemi sot dhe në të ardhmen". (A. De Lellio, *Kosova*, 2006, f. 160)

Një qëndrim të njëjtë mbajnë edhe intelektualët myslimanë, të cilët nuk kuptojnë përse kishat e Kosovës janë vetëm "serbe". "Në Kosovë, kishat (katolike dhe ortodokse) njihen si trashëgimi e të gjithëve, e popullit që i ndërtoi, u lut para Zotit në to dhe jetoi përreth tyre shekuj me radhë. Nuk mund ta çirni kulturën e ta nxirni jashtë Kosovës! Ajo kulturë është e popullit të Kosovës dhe askuj tjetër!". (Deklaratë. *Vetëvendosja*, Illyria, 3 nëntor 2006)

Prof. Michael Kiel (Hollandë) shpjegon: "Vjedhja dhe konfiskimi i fshatrave serbe, kishave dhe manastireve ... nuk është e vërtetë. Përndryshe, nuk do të kishim asnjë gjurmë të kulturës serbe në Kosovë... Monumentet u mbrojtën nga roje



të armatosura të zgjedhura në mes të popullsisë shqiptare, në territoret ku gjindeshin monumentet, të konfirmuara nga organet kishtarë serbe dhe me urdhër të Sulltanit" (De Lellio, *Op. cit.* f. 45).

Mendime të kësaj vërtetohen edhe nga vizita e patriarkut serb Gherman në Pejë (1960) dhe dekorimi i familjes shqiptare Nikçi për mbrojtjen e Patrikanës së Pejës brez pas brezi. Kjo është tradita shqiptare qysh nga shekulli XIV-të dhe XV-të.

Argumentat fetare e kulturore të së kaluarës dhe të së tashmes historike të popullit serb përdoren dhe shpërdoren, për arsye të propagandës politike. Më 25 gusht 2006, patriarku rus Alexy foli për mundësinë e një autonomie (sic!) për Kosovën, si "... e vetmja zgjidhje e së ardhmes së krahines dhe zhvillimit ekonomik... pavarësia për Kosovën do të ishte katastrofë" (TASS)

Kësaj propagande i bashkangjitet edhe gënjeshtria. Më 5 tetor 2006, *The Financial Times* raportonte se evangjelistët amerikanë, rev. Jerry Falwell dhe rev. Pat Robertson, zhvillojnë një fushatë të fortë në Washington D.C. që Kosova të mbetet nën Serbinë, "... duke luftuar kundër pavarësisë së Kosovës si një krahinë kryesisht myslimane... Siç duket Mesjeta dhe luftat fetare nuk janë larguar nga Ballkani." Një gënjeshtër të këtillë iu përgjigj kleriku protestant në Kosovë, Dr. Jonathan E. Askew, i cili ankohet për "... degradimin dhe mbrapësinë e propagandës serbe

të organizuar nga lobi Serbnet në Washington D.C. Evangjelisti rev. Robertson sqaron: "... Unë nuk kam bërë asnjë deklaratë (siç pretendon peshkopi Artemije) në lidhje me situatën në Kosovë. Frazologjia që kundërshton pavarësinë e saj është krejtësisht e papërshtatshme në lidhje me natyrën e diskutimeve midis peshkopit dhe rev. Robertson". (*Letter: Robertson to Askew*, 2 nëntor 2006). Ndërkaq versioni i gënjeshtërt i peshkopit Artemije është shpërndarë në të gjithë anëtarët e Kongresit amerikan nga Serbnet.

Kosova sot është angazhuar në një përpjekje për jetë a vdekje për të siguruar lirinë e popullit të saj dhe çlirim-in e vendit me anë të pavarësisë. Bisedimet për Kosovën po zgjaten më shumë se më parë. Pas zgjedhjeve serbe të 21 janarit 2007, problemi i Kosovës do të vihet përsëri në tryezë. Parashikohet një këmbëngulje ruse, aleate tradicionale e Serbisë, që Kosova të mos fitojë pavarësinë. Nuk dihet ende "karta kineze". Disa vende si Spanja dhe Greqia janë për një "shtyrje" të afatit të pavarësisë. Gjermania dhe Italia përpiqen të "temporizojnë" në prit-

je të një gjendjeje politike më të mirë në Serbi. SHBA-ja, Anglia dhe Franca mbeten bloku më i fortë që kërkon një zgjidhje përfundimtare të problemit që parashikon (ose që nuk përjashton) pavarësinë.

Në arenën ndërkombëtare, shqiptarët e Kosovës për të parën herë në historinë e tyre janë aktorë kryesorë dhe kanë mbështetës të fuqishëm. Faktori vendimtar janë vetë dy milionë shqiptarët e Kosovës, viktimat të agresionit gjenocidal serb për më shumë se njëqind vjet dhe vendosmëria e tyre për të jetuar të lirë.

Çdo shqiptar, kudo qoftë, ka për detyrë morale të lehtësojë dhe shpejtojë procesin e pavarësisë së Kosovës. Një Kosovë e lirë, e pavarur, demokratike, e bashkueme dhe europiane do të jetë një shtet i ri ligjor dhe një faktor pozitiv me rëndësi për paqen dhe stabilitetin politik në krejt Ballkanin.

*Baldwin, New York, SHBA
1 janar 2007*

TAKIMI I PARE I ANETAREVE TE ALB-SHKENCES (Tiranë, Gusht 2006)

Në gusht 2006 u zhvillua me shumë sukses takimi i parë i anëtarëve të Forumit dhe Institutit Alb-Shkenca në Tiranë. Në këtë takim morën pjesë rreth 60 vetë dhe fjalën përshëndetëse e mbajti z. Mariano Passerini, drejtor i universitetit italian "Këshilli i Zojës së mirë" në Tiranë ku u organizua takimi. Përshëndetën gjithashtu Dr. Ardian Maçi dhe Prof. Dr. Jahja Kokaj si përfaqësues nga Shqipëria dhe nga Kosova.

Në fjalën e tij përshëndetëse Prof. Myqerem Tafaj, sekretar i përgjithshëm në kryeministri dhe këshilltar i z. Berisha për arsimin, foli për zhvillimet më të fundit në reformën e arsimit dhe të shkencës në Shqipëri. Pas tij ndërhyri përfaqësuesi i UNDP-së në Shqipëri, i cili tregoi konkretisht për ecurinë e programit "Brain Gain" të ndërmarrë nga UNDP-ja tashmë në disa vende të Ballkanit. Të dy përfaqësuesit shprehën konsideratë për Alb-Shkencën si një or-

ganizatë dhe partnere serioze në Shqipëri.

Prezantime u paraqitën në këtë takim nga Lindita Komani dhe Albert Nikolla në të cilat u bë një përmbledhje e punës dhe përpjekjeve që po bëhen në kuadër të Forumit dhe Institutit Alb-Shkenca për të organizuar diasporën shkencore shqiptare dhe për të rritur ndikimin e saj sidomos në jetën shkencore dhe akademike në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Prof. Begzad Baliu, Dr. Naim Shabani dhe Albert Nikolla dhanë pika orientuese për Seksionet shkencore të Institutit Alb-Shkenca të cilat ata drejtojnë.

Ky takim i parë prezantues dhe njohës i Alb-Shkencës u mbyll me një darkë të sponsorizuar edhe nga UNDP-ja.

Gjatë gushtit 2007 do të kryhet takimi i dytë i Alb-Shkencës në Prishtinë. Për këtë ju ftojmë të gjithëve të ndihmoni aktivisht me ide, materiale për tu paraqitur dhe pjesëmarrjen tuaj për një sukses tjetër.



Zef Skiroi (prosenior) dhe shkrimet e tij shqip drejtuar Papë Benediktit XIV

Joseph Schiro' (prosenior) and his writings in Albanian to Pope Benedictus XIV

Nxitës i këtij studimi që m'u lejua ta përcjell në mënyrë të thukët në këtë revistë – tashmë të mirënjohur në rrethet e lexuesve shqiptarë dhe të huaj –, u bë një shkrim informativ i arkivistit të apasionuar Musa Ahmeti (2003, 90v.), i cili ofron në të të dhëna të sakta bibliografike mbi pesë tekste të shkurtra shqip, që mbajnë firmën e priftit arbëresh At Zef Skiroit (= lat. Joseph Schiro, it. Giuseppe Schirò: 1690-1769), ish-arqipeshkëv i Dioqezës së Durrësit dhe vikar apostolik i misionit të Himarës. Këto tekste janë përfshirë të plota në bleun VII të botimit të dytë të zgjeruar të veprës *Opera Omnia* (Romë 1767, 81, 121, 143v., 166v., 190) me autorësi Papë Benediktin XIV.

Njohja, botimi dhe interpretimi gjuhësor-filologjik i këtyre teksteve rezulton të jetë disavlerësh: a) së pari, ato na paraqiten si dokumenti më i hershëm zyrtar, i botuar që njohim gjer më sot, në të cilin shqipja përdoret si mjet komunikimi ndërinstitucional, madje në marrëdhënie me instanca të tilla të larta siç janë Kuria e Shenjtë dhe vetë kreu i saj, Papa¹; b) së dyti, ato mundësojnë zbardhjen e ndonjë pamjeje ende të pasqaruar shterueshëm në vetë personalitetin e hartuesit të tyre si njëri ndër veprimtarët kryesorë të misionit apostolik në Himarë përgjatë gjysmës së parë të shek. të 18-të (Borgia 1942, 127vv.) e, më pas, si pjesëmarrës aktiv në rrethin intelektual-fetar italo-arbëresh, të organizuar pranë kolegjeve arbëreshe të Palermos dhe Horës së Arbëreshëve në Sicili (*Roma d'Oriente* VII [1914] 279vv.; Sciambra 1967, 393vv.); e c) së treti, edicioni kritik i këtyre letrave lejon gjithashtu përditësimin me vetë gjuhën e autorit, duke shtruar njëherësh për diskutim çështje që lidhen (pa)ndërmjetshëm me shkallën e zhvillimit të kulturës së shkrimit shqip me alfabet latin në këtë periudhë, si edhe me rindërtimin e marrëdhënieve të ndërsjella që mund dhe duhet të jenë zhvilluar gjatë kësaj periudhe ndërmjet arealit kulturor italo-arbëresh dhe gjegjësit të tij në Shqipërinë e Veriut.

Përcollëm kështu përmbledhtas disa ndër çështjet kryesore që synojmë të shtjellojmë në këtë studim. Pas një skicimi të thukët të profilit biobibliografik të Skiroit, së bashku me stacionet kryesore të aktivitetit të tij misionar e shekullar, do të thellohem në çështje që li-

dhen me sfondin historik-kulturor të këtyre teksteve shqipe, si p.sh. me kohën dhe arsyet e hartimit të tyre. Qëllimi kryesor i punimit mbetet gjithsesi botimi i tyre, çka parakupton njëkohësisht edhe shtetimin e zgjidhjen e disa problemeve që ngërthejnë, ndër të tjera: zbërthimi i kodit grafik, rregullat ortografike të zbatuara në to, si edhe vendi që zënë këto tekste në lëvrimin e shkrimit shqip me alfabet latin në mes të shek. të XVIII.

I. Profil i thukët biobibliografik i Zef Skiroit

Emri dhe personaliteti i Skiroit është më se i njohur në historikun e misioneve apostolike të Kishës Katolike-Romake në Shqipëri si edhe në atë të arealit kulturor italo-arbëresh gjatë shek. XVIII. E për këtë i jemi padyshim mirënjohës biografit të tij, Nilo Borgia-s (1942, f. 127-201), por jo më pak vetë Skiroit. Kujtimet e tij ende në dorëshkrim: *Requisiti di Giuseppe Schirò Arcivescovo di Durazzo, già Vicario Apostolico della Provincia di Cimarra nell'Epiro per lo spazio di anni XXIV, dal medesimo raccolti e messi insieme in Roma nell'anno del Signore MDCCXLVIII*, mbeten sot për sot burimi kryesor lidhur me të dhënat e ndryshme me karakter biografik dhe veprimtar të autorit tonë. Domethënës në këtë pikë është edhe fakti që, pas hedhjes në letër të kësaj autobiografie (Romë 1748) e deri në mbyllje të jetës së tij (3 dhjetor 1769), të dhënat biografike mbi të rrudhen tej mase. Përndryshe ndeshim të botuara në disa periodikë ekleziastikë-shkencorë një numër relacionesh dhe shkrimesh origjinale italisht², që plotësojnë më tej portretin e Skiroit në veprimtarinë e tij intelektuale-fetare. Andaj në këtë studim nuk na mbetet tjetër, veçse të citojmë me stil telegrafik stacionet kryesore të jetës dhe të veprimtarisë së tij.

1. Fëminia dhe edukimi (1690-1717)

– Skiroi lindi në vitin 1690 në Horën e Arbëreshëve të Sicilisë në një familje të thjeshtë arbëreshe, me prindër Gjergjin dhe Elenën (= Giorgio/Elena Schirò). Në vendlindje merr edhe mësimet e para, pas gjase nga vetë Gjergj Guxeta (= Giorgio Guzzetta), i njohur në his-

toriografinë arbëreshe si “l’apostolo degli Albanesi della Sicilia”.

– Dorëzohet murg që në në moshë të re në manastirin bazilian të Munxifit (= Mezzoiuso), ku fillon mësimet e rregullta nën drejtimin e At Vasil Matrangës (= Basilio Matranga).

– Në vitin 1710 transferohet në Romë, në kolegjin pontefikal të Shën Thanasit (= Collegio Pontefico di San Atanasio), ku vazhdon për 6 vjet studimet e larta në gjuhët latine dhe greke, si edhe në filozofi e teologji spekulative e dogmatike. Vajtja në Romë përkon në kohë me shpërnguljen në atë kolegji të mësuesit të tij, At Matrangës, i cili mendohet të ketë qenë edhe shuguruesi i Skiroit në korrik të vitit 1714.

2. Në Shqipëri si Vikar Apostolik i Himarës dhe Arqipeshkëv i Durrësit (1716-1741)

– At Matranga, i emëruar ndërkohë edhe si ipeshkëv i Dionisiopolis-it, merr me vete Skiroin në misionin apostolik të Himarës. Vështirësitë e rastit çojnë në ndërprerjen e parakohshme të misionit, i cili nuk zgjat më shumë se dy vjet (1716-1718), dhe kthimin e të dy misionarëve në Romë. Në Romë: “*gli fu da questo [= Matranga, B.D.] commessa la direzione del Noviziato del Monastero di Grottaferrata, del proprio Ordine, che sta sul Tuscolano.*” (Requisiti, sh. Borgia 1942, 194)

– Kongregacioni i Shenjtë e ridërgon në misionin e Himarës për një periudhë fillimisht dhjetëvjeçare (1721-1729), këtë radhë në cilësinë e vikarit apostolik dhe “*in compagnia di un solo Chierico Siciliano Albanese*”.

• Relacioni i parë (28.12.1722³): paraqet shumë interes, ndër të tjera, edhe për informacionin e hollësishëm me karakter historik-etnografik për rreth 14 fshatra ende të krishtera që përfshinte atëkohë misioni.

– Skiro kthehet përkohësisht në Romë (1729-1730?).

• Në Romë Skiroi hedh në letër relacionin e dytë (1729⁴), në të cilin propozon, ndër të tjera, zgjatjen e misionit: a) sepse s’ishin përgatitur ende klerikë vendas, të cilët do të merrnin përsipër përkujdesjen shpirtërore të popullsisë që i mbetej besnike besimit të krishterë; b) sepse kjo popullsi ngërthente një potencial të mundshëm ushtarak në luftën kundër turqve; dhe c) sepse “... anzi si faciliterebbe con l’assistenza Divina non solo la conversione delle restanti Terre, ma si aprirebbe la strada a penetrare an-cora più dentro la confinante Albania.” (Requisiti, sh. Borgia 1942, 146-7).

– Skiro rikthehet në misionin e Himarës (1730-1735), i shoqëruar këtë radhë nga tri misionarë bazilianë me origjinë arbëreshe:

• Letër raportuese mbi rëndësinë e misionit (7 maj 1732⁵),

• Letër e përbashkët e misionarëve (7 gusht 1732⁶).

– Vizita e tretë e përkohshme në Romë (1736).

• Relacioni i tretë (1736⁷),

– Me breven e datës 2 mars 1736 (Borgia 1742 184)

Skiroi shpallet zyrtarisht arqipeshkëv i dioqezës së Durrësit;

– Përpjekje afatgjata për t’u rikthyer në mision (1736-1741): Gjatë rrugës së kthimit për në Shqipëri, Skiroi lejohet të vërë këmbë vetëm për një ditë në dioqezën e Durrësit, ndërsa për t’u lejuar të hyjë në Himarë do t’i duhet të presë më kot, thuajse pesë vjet, në ishullin e Korfuzit me shpresë se dikur do të përmirësohej e ash-tuquajtura gjendje lufte në rajon⁸.

• Letër drejtuar prefektit të përgjithshëm të misionarëve bazilianë (20 shtator 1737⁹)

3. Kthimi përfundimtar në Romë (1741-1769)

– Në vitin 1741 Skiroi kthehet përfundimisht në Romë. Në kujtimet e tij ai, ndër të tjera, shkruan:

“*Nel 1741 finalmente Mr. Schirò venne a Roma per l’ultima volta. Ebbe la grazia di rassegnarsi e baciare i piedi del nuovo Sommo Pontefice Benedetto XIV felicemente regnante. ... Da allora in poi è stato nell’inazione fino a tanto che poi fu comandato di impiegare il suo poco tempo in servizio della Chiesa.*” (Requisiti, sh. Borgia 1942, 194).

• Fillimit të kësaj periudhe – gjithsesi para shpalljes së bulës papnore *Etsi pastoralis* (26 maj 1742), të firmosur nga Papë Benedikti XIV (sh. shën. 19) – i takon shkrimi shumë i rëndësishëm i Skiroit *Distinzione degl’Italo-Greci e degl’Italo-Albanesi*¹⁰.

– Ndër veprimtaritë e tjera të Skiroit në këtë periudhë – krahas funksioneve në kolegjin e Shën Thanasit, përkatësisht në kishën e këtij kolegji – shtojmë këtu, siç shkruan vetë Skiroi në kujtimet e tij:

“... con invito di intervenire alli Concistori semipubblici tenuti nel Quirinale, previi alla Canonizzazione solennizzata ultimamente. E benchè, attesa la sua povertà, non fosse in istato di presentarsi in detti Concistori con qualche mediocre accompagnamento, convenevole alla decenza del proprio carattere, non lasciò di intervenire; e fu (il) solo che in quella venerabile Augusta Assemblea siasi sentito votare in tre differenti idiomi: Latino, Greco ed Epirotico” (Requisiti, sh. Borgia 1942 195).

– Siç u cek shkurt edhe pak më lart, për periudhën pas hedhjes në letër të kujtimeve të tij (1748), dimë, përkatësisht është botuar deri sot shumë pak mbi jetën

dhe aktivitetin e Skiroit. Duhet të ketë qëndruar gjithsesi në detyrë pranë kolegjit dhe/ose në kishën e Shën Thanasit deri në fund të jetës së tij.

– Skiro ndërron jetë më 3 dhjetor 1769. *“Il suo cadavere ebbe onori straordinari nella Chiesa di S. Atanasio.”* (Borgia 1942, 197).

II. Shkrimet shqip të Skiroit dhe sfondi i tyre kulturor-historik

Zbulimi i teksteve shqip nga Musa Ahmeti zgjidh njëherësh enigmën e mbetur pezull në memoriet e Skiroit, ku ai shkruan se *“... fu (il) solo che in quella venerabile Augusta Assemblea siasi sentito votare in tre differenti idiomi: Latino, Greco ed Epirotico”*. Ky pohim, siç do ta prekim edhe më poshtë, lidhet pandërmjetshëm me këto tekste, të cilat na paraqiten të botuara edhe në versionet përkatëse latinisht (një tekst edhe në greqisht).

1. Përmbajtja e teksteve

Megjithëse janë hartuar (edhe) shqip, këto pesë tekste përmbajnë një tematikë krejt “të pazakonshme”, në kuptimin që qëllimi i shkrimit të tyre duket të jetë larg qerthullit të shumëpritur nocionor ‘shqiptar ~ (italo-) arbëresh’. Lidhur me përmbajtjen e tyre mund të përmbledhim shkurt se ato janë pjesë e procedurës për kanonizimin e pesë kandidatëve për shenjtorë të Kishës Katolike-Romake, aktiviteti i të cilëve s’ka kurrëfarë lidhje me veprimtarinë e këtij institucioni ndër shqiptarë apo arbëreshë, përkatësisht në hapësirat e tyre jetike. Në to bëhet fjalë për rekomandimin me shkrim dhe votimin që duhej të bënin deputetët e Asamblesë Gjysmëpublike (= *Consistorium Semi-publicum*) pranë Kurisë së Shenjtë gjatë procedurës së shenjtërimit¹¹ të të lumnuarve Camillo de Lellis, Caterina de Riccis, Petrus Regalat, Phidelius de Sigmaringa dhe Joseph de Leonissa¹².

2. Kur u shkruan këto tekste?

Një pyetje më se e natyrshme, përderisa asnjë prej këtyre teksteve nuk na kumton datën përkatëse të hartimit. Për më tepër, edhe shkrimi biografik i Borgia-s – ndoshta në të vetmin rast – është disi përvdjerrës, meqenëse shtyn dashur pa dashur në kohë datat e shenjtërimit të (disa prej) të lumnuarve të përmendur më lart, khs.:

“Ma, oltre a questa canonizzazione, tenuta probabil-

mente nel 1747, se ne ebbe nel 1749 ed anche nel relativo Concistoro semipubblico prese parte Mr. Schirò e precisamente quando si trattò della canonizzazione dei Beati Fedele da Sigmaringa, Giuseppe da Leonessa e Caterina de Riccis.” (Borgia 1942, 196)

Për një datim deri diku të përafërt të këtyre shkrimeve ndihmon padyshim kalendari i ceremonisë së shenjtërimit të kandidatëve të mësipërm, ku pjesëmerr vetë Papë Benedikti XIV, si edhe regjistrimi i përpiktë i procedurave – së bashku me datat e mbledhjeve dhe votimet përkatëse – në Asamblenë Gjysmëpublike, të cilat u zhvilluan radhazi përgjatë muajit qershor 1746¹³. Këtë periudhë mund ta konsiderojmë – qoftë edhe *ad hoc* – si periudha më e mundshme e hedhjes në letër të qëndrimeve të Skiroit për kandidatët në fjalë.

3. Përse shkroi Skiroi shqip?

Përmbajtja e teksteve, qëllimi kryesor i hartimit të tyre, sikurse edhe rrethanat, në të cilat janë botuar, nuk mundësojnë aspak një përgjigje të saktë ndaj pyetjes së pritshme, se përse pena e Skiroit ka shkruar në këtë rast (edhe) shqip. Kjo çështje ngrihet vetvetiu, në qoftë se kemi parasysh që Skiroi i është drejtuar shqip një instance të lartë kishtarë, në një kohë kur komunikimi zyrtar në latinisht ishte në rend të ditës. Shfletimi sado i kujdesshëm i gjithë procedurës së vëllimshme të votimit me rekomandimet përkatëse na siguron vërtetësinë e pohimit të bërë nga vetë Skiroi në kujtimet e tij, se ai që i vetmi në atë asamble që u dëgjua të votojë në tri gjuhë të ndryshme: latinisht, epirotisht (= shqip) dhe greqisht.

Tekstet shqip të Skiroit nuk japin gjithsesi asnjë shkas për hulumtime të mëtejshme në këtë drejtim. Në qoftë se nuk mbajmë parasysh firmën e tij të zakonshme në të pesë referencat si arqipeshkëv i Durrësit dhe vikar apostolik i Himarës “ndë Arbënit”, emri i dheut të Arbënit përmendet në këto tekste në një rast të vetëm, pikërisht në tekstin e dytë (sh. faksimile – T 2), madje edhe

Papa Benedikti XIV-të që drejtoi Vatikanin nga viti 1740 deri në vdekjen e tij në vitin 1758



këtu pak a shumë në të njëjtin kontekst me atë të firmës, khs.:

"... Andai i lumri At të lutemi e të falemi gjith s[]jemi, edhe unë prë pjes të Arbënit të shkruash edhe këtë ndë të tjerë shetëna."

Një farë orientimi në kërkimin e mëtejshëm lejon ndoshta fraza gjege në tekstin latin, e cila, në përjasje me atë shqip, edhe vizualisht na paraqitet shumë më e detajuar në pjesën përmblylëse.

"... Hanc gratiam, BEATISSIME PATER, jamdiu ingenti desiderio optat & Urbs & tota christiana Republica; hanc ipsam exoptat augustus iste Senatus; & pro ista ego quoque, licet omnium indignissimus, venerabundus sistens coram Tuo Apostolico Throno, humillimas fundo preces, etiam nomine totius Epiri, sive Albaniae, ex qua originem duco, uti jam benignissime exepisti loquentem proprio Idiomate."

Në këtë pjesë vemë re se autori i kumton Papës, përpos statusit të tij si përfaqësues i dheut të Arbënit, edhe origjinën dhe gjuhën e vet amtare, siç vijon, khs.: " (...) e për këtë unë ..., megjithëse më i padenji nga të gjithë, duke qëndruar me nderim përpara fronit tënd, paraqes lutjet më të përulta edhe në emër të gjithë Epirit, domethënë të Arbërisë, prej nga e kam origjinën, duke qenë se me shumë dashamirësi pranove të shprehem në gjuhën e tij."

Duke u nisur nga përmbajtja e këtij citati në latinisht, si edhe nga fakti që Skiroi nuk ngurron t'i shkruajë papës edhe në greqisht, lejohemi të përsiasim këtu, që shkrimi i teksteve shqip (dhe greqisht) do të mund të gjente shpjegim në klimën e re të krijuar në arealin kulturor italo-arbëresh gjatë kësaj periudhe, e parë kjo si rrjedhojë e zhvillimeve të brendshme në lëvizjen intelektuale-fetare arbëreshe përgjatë aksit Horë/ Palermo-Romë, në të cilin bashkëveprojnë disa figura qëndrore të kësaj kulture, siç janë: Gjergj Guxeta e Pal Maria Parrini (= Paolo Maria Parrino) në Sicili dhe Pompilio Rodota (= Pompilio Rodotà) e padyshim Zef Skiroi në Romë. Faktor i jashtëm – që e thelloi edhe më shumë këtë lëvizje – është sigurisht bula e famshme e Papë Benediktit XIV (*Etsi pastoralis*, 25 maj 1742), në ngjizjen e së cilës mund dhe duhet të ketë pjesëmarrë në funksionin e njohësit dhe të këshilltarit vetë Skiroi.

Këtë kuadër e plotëson pa dyshim memoriali i Skiroit *Distinzione degl'Italo-Greci e degl'Italo-Albanesi* (Romë 1742), në të cilin autori synon të dallojë qartë brenda grupimeve të ritit bizantin në Itali bashkësinë e ashtuquajtur italo-greke (antike dhe moderne) nga ajo ita-

lo-arbëreshe. Për Skiroin kemi të bëjmë këtu me dy bashkësi etnike-fetare krejtësisht të dallueshme nga njëra tjetra, andaj edhe duhen identifikuar si të tilla: *italo-arbëreshë* (= Italo-Albanesi) kundrejt *italo-grekë* (= Italo-Greci). Krahës dallimeve në kuadrin e besimit kristian, d.m.th. atyre në planin teologjik si dhe në ushtrimin e ritit bizantin, Skiroi sjell në analizë komponentë të tjerë themelorë të kulturës etnike, siç janë: origjina e historia e këtyre ngulimeve në Itali (pas vdekjes së Skënderbeut), mënyra e jetesës e sidomos gjuha amtare e italo-arbëreshëve¹⁴. Gjykime të kësaj natyre i sigurojnë Skiroit një pozicion të veçantë në zhvillimet iluministe që përjetuan rrethet intelektuale arbëreshe në gjysmën e dytë të shek. XVIII.

III. Tekstet e Skiroit

Hetimi i përmbajtjes dhe i rrethanave social-kulturore, në të cilat u hartuan këto tekste, mbulon vetëm një pjesë të qëllimit të studimit tonë. Ribotimi i tyre filologjik përbën një tjetër hallkë të këtij qëllimi. Përmbushja e tij parakupton, ndër të tjera, shënimin dhe zgjidhjen e disa çështjeve që kanë të bëjnë me zërbërthimin e kodit alfabetik dhe njohjen e rregullave grafike e ortografike, të zbatuara në to. Paraqitja paraprake dhe rezultative e hulumtimit të këtyre çështjeve shpresojmë që të lehtësojë leximin e vetë teksteve shqip, të cilat do t'i japim paralelisht në versionin e transkriptuar (A = transkriptim diplomatik) dhe në atë të transliteruar (B = transliterim diplomatik). Këto së bashku me faksimilet e versioneve origjinale shqip dhe latinisht janë përfshirë të gjitha së bashku në fund të punimit.

Një vështrim sado i shpejtë i këtyre teksteve të krijon menjëherë përshtypjen se në to është zbatuar i ashtuquajtur 'alfabet i Propagandës', më se i njohur në botimet shqip të arealit ose me destinacion arealin kulturor-fetar të Shqipërisë së Veriut (katolik) e – pas gjase – edhe atë të zonës (së krishterë) të Himarës (= Arbërisë).

Për më tepër syrit të filologut nuk i shpëton as fakti që kodi alfabetik i teksteve të Skiroit përkon thajse plotësisht me atë të zbatuar pak a shumë në të njëjën kohë prej gjakovarit Gjon Nikollë Kazazi (Demiraj 2006, 173), çka e përforcon edhe më shumë mendimin se midis dy arealeve kulturorë në shqyrtim, në këtë periudhë nuk kanë munguar përpjekjet e përbashkëta (sado në embrion) në lëvizimin e kulturës së shkrimit shqip¹⁵.


IV. Përfundim

Mbyllim këtu punimin tonë, duke përmbledhur shkurt se emri i Zef Skiroit (? prosenior – 1690-1769) mund dhe duhet të përcillet tashmë në historiografinë e kulturës shqiptare si një ndër veprimtarët aktivë të rrethit kulturor-intelektual arbëresh në shek. XVIII, i cili – më se i vetëdijshëm për rolin e gjuhës si komponente themelore në matriksin e kulturave etnike –, shkruan me po aq vetëdije në gjuhën amtare, duke dëshmuar dhe për të dëshmuar me shkrim identitetin e vet etnik-gjuhësor "[in] nomine totius Epiri, sive Albaniae, ex qua originem duco, uti jam benignissime exepisti loquentem proprio Idiomate". Parë nga ky aspekt, pesë letrat e Skiroit – dokumenti më i hershëm zyrtar, që njohim deri

më sot, në të cilin shqipja përdoret si mjet komunikimi ndërinstitucional – fitojnë një vlerë të pallogaritshme, pasi sythojnë një pikë kulmore në ecurinë e mendimit intelektual shqiptaro-arbëresh. Leximi i tyre kritik lejon përditësimin me vetë gjuhën e hartuesit të tyre dhe shtron njëherësh për diskutim çështje që lidhen (pa)ndërmjetshëm me shkallën e zhvillimit të kulturës së shkrimit shqip me alfabet latin në këtë periudhë. Ngjashmëritë ndërmjet kodit alfabetik, të zbatuar në to me atë të autorëve të tjerë të kësaj periudhe (Gjon Nikollë Kazazi) nxisin dhe mundësojnë rindërtimin e marrëdhënieve të ndërsjella që duhet të jenë zhvilluar gjatë kësaj periudhe ndërmjet arealit kulturor arbëresh dhe adashit shqiptar në krahun tjetër të Adriatikut.

Faksimile të teksteve shqip e latinisht të Zef Skiroit
(botuar në *Opera Omnia VII*, Romë 1767)

Teksti I (f. 81)



Transliterimi

1 SHUM I LUMURI AT

Të bëmet, lëvdimet edhe ato që

k[] pësuanë prë f[]në të Krish-

5 tit robi i Tynzoti, Fidheli k[]

Sigmaringa, na dëftonjënë me-

aft, se aj qënka i vërtet,

i mirë edhe i besës ndë shtë-

p[]t Tynzoti, edhe stolisënë me të gjith

10 lëvdimet të Apostoljet. Ktë të vërtet desh

vet Zotyn të dëfton me shenjet që k[] bën

njer sod prë të falurit e prë të luturit atij

vet të lumurit njer[] Tash po duhet veçe s[]

shkruhet emëni i t[] me shejtënæ. Ashtu e mar


15 [...] me mend e mia të p[]d[]urat e ashtu

thom p[] fare frik.

Jozefi Skiro, Arçbiskupu i Durrsit edhe Vikar'

19 Apostoliku i Himarrs ndë Arbënit.

Teksti II (f. 121)



1 SHUMË I LUMURI AT

Pse të gjith ato kafsh q'duhenë

prë të shetënuanë të lumënë

5 Kamil de Lellis jan bënë njer

tasht fort mirë me h[] të Tynë-

zoti e me të madhenë urtës[]

tënde. Një punë vetëmë du-

het, s[] shkruhet ëmbri i t[]h me të tjerë she-

10 tënæ. Këjo nd[]r i tukon me gji-æ, pse pat

shum lëvdime e shum të dashunë prej Tynë-

zoti, o prej shokunë e fqinjënë. Këjo e da-

shunë duron sod e gjithmonë prë të ma-

dhenë shoqër[] ajo që shërben të sëmurtu-

15 rit. Zotyn k[] shum dëftuarë të madhenë shet-

n[]e t[]ë me shum shenje. Andaj i lumuri At

të lutemi e të falemi gjith s[]jemi, edhe

unë prë pjes të Arbënit, të shkruash edhe këtë

ndë të tjerë shetënæ.

20 Jozefi Skiro, Arçbiskupu i Durrsit e Vikar'

Apostoliku i Hymarrsë ndë Arbënit.

Teksti III (f. 143-4)

T LUMURI PIET'R REGALAT
CAA SPÆGNA,
SCIUM ILUMURI AT



YÆNÆ caa, eƿe cuur ifc iggyal
Kak imaƿƿ ſciet, ſaa ggiƿƿ
bota, egnæwla riƿƿ, e veyæ
tek' ay' ty truhey, e ty luteyæ
po ſi cuur t' ilctenæ imaƿƿ
ſciet e ſcium i diitunæ Profet.
Ayð vet fratenia e ſcietit Fran-
giſk, egnæh, eƿe elæv don
ſod, e ggiƿƿ monæ, ſe ay e caa mbæſuanæ,
e ndrekyunæ mbæ uƿæ mæ tæ Miræ. Ʒot n'
i maƿi e caa ndertunæ ndæ ktæ yet me ſcium,
e tæ mbæƿaa ſciegne. Præ andai loyas ſernæn-
dæ ƿƿomi paa frik, ſe præparat' Ʒoti ifct
gnæ imaƿƿ ſciet.

Jofefi Schirð Arçbiſcæpu i Durſit, e Vicar'
Apoſtolicu i Hymarrs ndæ Arbænit.

1 T'LUMURIT PIET'R REGALAT
K ƿ SPËNJA

SHUM I LUMURI AT.

5

Qënë k ƿ edhe k ƿ r ish i gjall
kaq' i math ſhet, s ƿ gjith
bota e njerëzia rrih e vejë
tek ai t' i truhey e t' i lutejë

10

poſik ƿ r t' iſhte një i math
ſhet e ſhum i d ƿ unë profet.
Ajo vet fratenia e ſhetit Fran-
giſk e njuh edhe e lëvdon
gjiſhmonë, ſe aj e k ƿ mbæſuanë

15

e ndrequnë mbë udhë më të mirë. Zotyn'
madhi e k ƿ nderturë ndë ktë jet me ſhum
e të mbëdha ſhenje. Præandaj llojas ſe mën-
dë thomi p ƿ frik, ſe præpara Tynzoti iſht
një i madh ſhet.

20

Jozefi Skiro, Arçbiſhkëpu i Durrsit e Vikar'

22 Apoſtoliku i Himarrs ndë Arbënit.

Teksti IV (f. 143-4)

NA ILUMURI AT.



Næ tietræ tæ ſkælkiem xompl hæ
na deſton præ tæ ndiecuræ ſcieta
Fratnij e Capuccinet me tæ lu-
murinæ Joſif' caa Leonilla. Præ
tæ vertet ſe ggiƿƿ ggela etiyh
na bie gna: eææ ſcium tæ miræ
ndæ hundæt tona. Pſe Ʒot'næ caa derſuræ mbij
tæ me doræ hapt po ſi vaugh, ggiƿƿ hiret; e
ggiƿƿ ƿunetiit ſepiertit ſceint. Eƿe e caa
bæææ po ſi æembra e tiih. Unæ nææ e mæ
me mænd' emia, tæ ƿƿom, e tæ nu mærogi
taſti ggiƿƿ lævdimet. Ktiyæ robbyt'n Ʒot.
Vec ecam me aſt ſe Kyſcia ſceinte i caa gno-
hunæ præ tæ mbæƿaa, tæ mira, e ƿe tæ vſ-
teta. Aſt' ƿƿom, e ƿe præ ſcegnæ, e mbre-
cullij, me ſe Ʒot'n caa ndertunæ Ktæ nobin'
etiyh. Taſti duhet vetæmæ. Saa ty ſcium
ilumuri At. Tæ haps, e tæ deſtoſc Ktæ tæ
bukur', e Ktæ tæ lævduam ſceint ne riij, ſa
te ndekgnæ ggiƿƿ bota, e ggiƿƿ Kriſtæ-
rymi.

Jofiſi Schirð Arçbiſcupu i Durſit, e Vicari
Apoſtolicu ndæ Arbænit.

1 NA I LUMURI AT

Një tjetrë të shkëlqiem ksoimplë
na dëfton prë të ndjekurë sheta

5

Fratn ƿe Kapuçinet me të lu-
murinë Joſif k ƿ Leonisa. Prë
të vërtet se gjith gjella e tijh
na bie një ƿ rë ſhum të mirë
ndë hundët tona. Pse Zotynë k ƿ derdhurë mb ƿ

10

të me dorë hapt poſi vahj gjith hiret e
gjiſh dhunët ƿ t shpiertit ſhejnt. Edhe e k ƿ
bënë poſi zëmbera e tijh. Unë nënk e mar
me mend' e mia të thom e të numuronj
taſhti gjith lëvdimet ktijë rob' Tynzoti.

15

Veç e kam meaft se Kiſha ſhejntë i k ƿ njo-
hunë prë të mbëdha të mira edhe të vër-
teta. Aſtu thom edhe prë ſhenjet e mbre-
kull ƿ me se Zotyn k ƿ ndertunë ktë robin'
e tijh. Taſhti duhet vetëmë s ƿ ti, ſhum


20

lumuri At, të hapsh e të dëftosh ktë të
bukur' e ktë të lëvduam ſhejnt njer' s ƿ
t' e ndjeknjë gjith bota e gjith Kriſhtë-
rimi.

25

Jofiſi Skiro, Arçbiſhkëpu i Durrsit e Vikari
Apoſtoliku ndë Arbënit.

Teksti IV (f. 143-4)



1 SHUM I LUMURI AT

E lumura Katerinë të Riçevet,
e bardh' vash e kallogr[] e shejt[]

5 Domenikë, njera sa rroi mbajt[]
fort, faqenë e shemëllinjë e
Tynzoti q' e kr[]oi me pastr[]

10 minë e sajë. Pasisi e u mëndua
s[] mendi të shëmëlleneh[] edhe Zotit Krish-

10 të që na shprëblei me vet mundimet e tij.
Ma pse me fuq[]hë e saj nënkundi të kish

15 ktë të madhe h[]. Jia dhuroi vet Krishti Zotyn
me shenjet e mundimevet që i tiposi mbë

15 të kriominë kufomë të asaj adha një vash
ashtu e qriurë, ashtu e munduarë edhe kaqë

15 shum e dashurë k[] Zotyn edhe tashti e nder-

20 turë me shum shenje të shejtër[]. Isht e
gjigjsë të nd[]rsh edhe ti, shum i lumuri At

20 vasha. Ashtu se të j[]t embri e së madhes
Shet Katerinë k[] Siena edhe aj i asaj që

25 isht k[] Fiorenca.

Jozefi Skiro, Arçbiskupu i Durrsit edhe Vicar
Apostoliku i Himarrs ndë Arbënit.

SHENIME

1. Më i hershmi dokument shqip mbetet sot për sot një letër në dorëshkrim dërguar Kongregacionit të Propaganda Fide-s nga pleq-
të e Gashit në vitin 1686 (Bartl & Camaj 1967 23vv.).

2. Khs. ndër të tjera: "Roma e l'Oriente" 3 [1913] (5) 113-117, 159-
166; (6) 220-231; 4 [1914] (7) 282-285; 340-349.

3. SOCG 641; botohet i plotë nga Borgia 1942 132-139.

4. "Roma e l'Oriente" 3 [1913] (5) 113vv.

5. Borgia 1942 163-171.

6. Borgia 1742 172-175.

7. "Roma e l'Oriente" 3 [1913] (6) 220vv.

8. Arsyen e vërtetë e mësojmë nga Borgia, sipas të cilit: "La guer-
ra contro i Chimarioti non fu che un semplice pretesto: la vera
ragione la riscontriamo in un largo verbale di una seduta della S.
Congregazione, tenuta il 24 aprile del 1775. Tra l'altro in esso
leggiamo: 'Intanto avendo il Re di Napoli levato un Reggimento di
Cimarrioti, questi si divisero, parte tenendo per la Repubblica Veneta,
cioè dire che ad essa sola si concedesse levar Soldati; e parte per il
Re di Napoli. Sicché essendo lo Schirò Siciliano venne in sospetto ai
Veneziani, onde non entrò nel Vicariato e la Missione restò abban-
data.'" (1742 193v.)

9. Borgia 1942 184vv.

10. "Roma e l'Oriente", 4 [1914] (7) 282-285; 340-349)

11. Kemi të bëjmë këtu me të ashtuquajturën „siguri morale“, e
fatur si procedurë e veçantë nën Papë Benediktin XIV (khs.: De
Lambertinus Opus De Servorum Dei Beatificatione et Beatorum
Canonizatione. Tomus IV, cap. VIII). Shih për këtë edhe linkun në
internet: <http://www.uibk.ac.at>

12. Të dhëna të shkurtra informative lidhur me këta shenjtorë: a)
Phidelijs de Sigmaringa (Fidelis von Sigmaringen - Markus Roy): lindi
më 1577/1578 në Sigmaringen (Baden-Württemberg/Gjermani); mar-
tirizohet më 24 prill 1622 në Seewis bei Chur (Zvicër) nga kalvinistët;
b) Camillo (Kamillus) de Lellis: themelues i Urdhërit të Kamilianeve
dhe padron i punonjësve sanitarë; lindi më 25 maj 1550 në Buchianico

(Itali), vdiq më 14. korrik 1614 në Romë; c) Caterina de Riccis
(Katharina de' Ricci -K. nga Firenze): mistike; lindi më 23 prill 1522,
vdiq më 1 shkurt 1590; d) Petrus Regalat (Pedro Regalado): anëtar i
Urdhërit Françeskan; mistik; lindi në vitin 1390 në Valladolid (Spanjë);
vdiq më 30 mars 1456 në La Aguilera; e) Joseph de Leonissa: misio-
nar i Urdhërit të Kapucinëve, mistik; lindi më 8 janar 1556 në Leonissa
(malet Sabine/Itali); vdiq më 4 shkurt 1612 në Amatrice. Shih për ta
më hollësisht Schaubert - Schindler (1999 *passim*).

12. Të pesë kandidatët u shpallën shenjtorë nga Papë Benedikti
XIV në qershor 1746. I gjithë vëllimi i shtatë i veprës së tij (Opera
omnia) pasqyron në detaj procedurën zyrtare, me kohëzgjatje dy-
vjeçare (1745-1746) së bashku me ceremonialin përkatës të kanoni-
nizimit.

13. Shih më hollësisht për këtë çështje, krahas Schirò 1742 [340vv.],
edhe Rodotà 1758 128vv.; për qëndrimin e Parrinit për këtë problem,
sh. Sciambra 1967 291v.

14. Për kontakte të vazhdueshme midis dy arealve në këtë peri-
udhë dëshmon edhe letra që Gjon Nikollë Kazazi i dërgon Gjergj
Guxetës, në të cilën i kumton zbulimin e 'Mesharit' të Buzukut.
(Mandalà 1994 4; Demiraj 2005).

16. Dëshiroj të falenderoj këtu miqtë e mi, Altimari dhe Mandala,
për ndihmën e pakursyer lidhur me zbërthimin e disa frazave të
vështira në tekst. Gjithsesi është autori i këtij shkrimi ai që mban
përgjegjësinë për çdo parregullsi të mundshme që mund të diktohet
në të ardhmen.

17. Lexim i paqartë. Thujse e njëjta situatë me pjesën ndjekëse:
<me mbndemia>, të cilën e kemi zbërthyer në <me mbnd e mia>, duke
fiksuar kështu një gabim shtypi: mend] mbnd.

BIBLIOGRAFI

A. Burimet

Schirò, G.: *Alla Sacra Congregazione de Propaganda Fide. -
Relatione della Missione della Provincia di Cimarra nell'Epiro per il*

P.D. Giuseppe Schirò dell'Ordine di S.Basilio in Italia, Vicario Apostolico della sudetta Provincia di Cimarra. 1729; në: "Roma e l'Oriente" 3 [1913] (5) 113-117, 159-166.

– *Il Relazione di Mons. Giuseppe Schirò sulla Missione di Cimarra (anni 1730-1735)*, në: "Roma e l'Oriente" 3 [1913] (6) 220-231.

– *Distinzione degl'Italo-Greci e degl'Italo-Albanesi* në: "Roma e l'Oriente", 4 [1914] (7) 282-285; 340-349.

– *Requisiti di Giuseppe Schirò Arcivescovo di Durazzo, già Vicario Apostolico della Provincia di Cimarra nell'Epiro per lo spazio di anni XXIV, dal medesimo raccolti e messi insieme in Roma nell'anno del Signore MDCCXLVIII* (pasazhe të botuara nga Borgia, N.: I monaci basiliani d'Italia in Albania. Appunti di storia missionaria (Secoli XVI-XVIII). Periodo secondo, Roma 1942.)

B. Literaturë

Ahmeti, M.: *Gjuha shqipe pasurohet me dokumente të reja të pan-johura deri tash*, në: "Ekskluzive", nr. 37 [2003] f. 90-1.

Altimari, F.: *Studi linguistici arbëreshë*, nr. 12 i serisë "Radhontë e zjarrit" 1988.

Bartl, Peter [& Camaj, Martin]: *Ein Brief in albanischer Sprache aus Gashi vom Jahre 1689*, në: *Zeitschrift für Balkanologie* 5 [1967] 23-33.

– *Zur Topographie und Geschichte der Landschaft Himara in Südalbanien*, në: *Münchener Zeitschrift für Balkankunde*, Bd. 7.-8., München 1991 311-354.

Borgia, Nilo: *La missione dei monaci basiliani d'Italia in Albania*, në: "Roma e l'Oriente" 3 [1913] (5) 97-117, 159-166.

– *La missione dei monaci basiliani d'Italia in Albania*, në: "Roma e l'Oriente" 3 [1913] (6) 209-231.

– *Contributo alla storia del rito greco in Italia*, në: "Roma e l'Oriente", 4 [1914] (7) 272-285; 340-352.

– *I monaci basiliani d'Italia in Albania. Appunti di storia missionaria (Secoli XVI-XVIII). Periodo secondo*, Roma 1942.

Demiraj, B.: *Viti i zbulimit të 'Mesharit' të Buzukut dhe ndonjë çështje që lidhet me të*, në: "βίβλος" 26 [2005] 47-53; Palermo

– *Gjon P. Nikollë Kazazi dhe 'Doktrina' e tij*, Prishtinë 2006

Farlati, D. & Coleti, S.: *Illyrici Sacri*, T. VII: Ecclesia Diokletiana, Antibarensis, Dyrrachiensis, et Sirmiensis cum earum suffraganeis, t. VII, Venetiis, MDCCCXVII.

Kazazi, Gj. N.: (Joanne Nicolovich Casasi) *Breve Compendio della Dottrina Cristiana (Tradotta in lingua Albanese per l'utilità, e istruzione dei Fanciulli die quella Nazione)*, Roma, MDCCXLIII, nella Stamperia della S. Congr. de Propaganda Fide.

Guzzetta, A.: *La parlata di Piana degli Albanesi*, Parte I – Fonologia, Palermo 1978.

Mandalà, M.: *Nicolò Chetta; Nel bicentenario (1803-2003)*, Palermo 2003.

– Luca Matranga, *E Mbsuame e krështerë (a cura di Matteo Mandalà)*, në serinë: "Albanica", nr. 21, Caltanissetta 2004.

– *La lettera inedita (1740) di Mons. Nicola Kazazi a P. Giorgio Guzzetta*, në: "βίβλος" 1994, 4.

Rodotà, P.: *Dell'origine, progresso, e stato presente del rito greco in Italia osservato dai greci, monaci basiliani, e albanesi*, Vol. III, Roma 1758.

Schauber, V. & Schindler, H. M.: *Bildlexikon der Heiligen, Seligen und Namenspatrone*, VI. Pattloch, München 29. Juni 1999.

Schirò, G.: *Opere*, vol.VIII 189; 294-5.

Sciambra, M.: *Paolo Maria Parrino, scrittore siculo-albanese*, në: "Shejzat (Le plejade)" 11 [1967] (1-4) 134-156, 281-301, 393-434.

VJESHTA ME E NXEHTE E 500 VJETEVE TE FUNDIT

Muajt e shtatorit, tetorit dhe nëntorit kanë qenë më të ngrohtët e Europës këtë gjysmë shekullin e fundit. Këtë e tregojnë të dhënat e analizuar nga studiuesja e Universitetit të Bernës, Elena Xoplaki.

Të dhënat meteorologjike tregojnë se temperaturat e shtatorit dhe tetorit kanë qenë mesatarisht 11 gradë d.m.th. 1.8 gradë më të larta se mesatarja e përgjithshme e këtyre muajve. Nëntori ka qenë rreth 2.5 gradë më i nxehtë se mesatarja. Kështu del se kjo vjeshtë ka kapërcyer edhe ato më të nxehtat e së kaluarës si ajo e viteve 1772, 1938 dhe 2000 me rreth 1 gradë. Përveç këtyre të dhënave, Xoplaki kërkoi të studiojë edhe klimën e stinëve të kaluara në bazë të vëzhgimeve të kryera nga murgjit, mjekët dhe studiues të tjerë të atyre viteve. Nga kjo analizë del se vjeshta e fundit ka qenë ndër më të jashtëzakonshmet duke marrë parasysh edhe gabimet e matjeve në të kaluarën.

"Një vjeshtë e ngrohë në një zonë apo në një tjetër të Europës nuk do të kishte ndonjë problem të madh, – shpjegon një klimatolog tjetër, Juerg Luterbacher, – çështja qendron se ky fenomen i pazakontë shtrihet në gjithë kontinentin, nga Islanda në Greqi".

Tendenca e përgjithshme është: temperaturat vjeshtore në Europë janë ngritur me rreth 0.45 gradë çdo dhjetë vjet këto 30 vitet e fundit.

Ngrohja më e madhe është regjistruar në Ishujt Britanikë, Skandinavi dhe disa zona të Arktikut. Në të kundërt, zona të gjera të ShBA-së kanë pasur temperatura nën mesataren.

Dy ekspertët zvicerianë kërkuan të kuptojnë edhe ç'dimra do na presin në të ardhmen. Pas 30 vjeshtave të më të nxehta të arkivave të tyre, dhjetori dhe shkurti kanë qenë muajt më të nxehtë të mesatares europiane ndërsa janari muaji më i ftohtë.


Nature

Titullin e tragjedisë shekspiriane *Othello, the Moor of Venice*, Noli e përktheu në vitin 1916 si “Arap i Venedikut”, duke i qëndruar besnik përfytyrimit popullor jo vetëm shqiptar, por krejt evropian të Mesjetës, që i megjullonte disi dallimet midis arabëve (*mauri*) dhe negroidëve afrikanë (*aethiopes*). Vetë këta *Moors* (sp. *moros*, it. *morì*) – që gjetiu i kam gjetur të quajtur në shqipe si “maurë”¹ identifikoheshin kryesisht nga lëkura e tyre e zeshkët dhe nga prejardhja e tyre afrikane; sadoqë etnikisht kanë qenë gjithnjë më tepër arabë e berberë, sesa diçka tjetër; dhe Evropës i janë bërë të njohur në krye kur arabët e kishin kalifatin edhe në trojet e Spanjës së sotme. Fjala vetë mendohet se vjen në thelb nga greqishtja *mauros*, me kuptimin “shumë i errët, i zeshkët”; maurët e Mesjetës si banorë të brigjeve afrikane të Mesdheut dhe piratë të rreptë mund të kenë qenë kështu edhe një popullsi e përzier, arabo-berbere dhe zezake sub-sahariane. Nëse Shekspiri e kishte menduar *Othello*-n afrikan të zi apo maur berber, kjo nuk përcaktohet dot me siguri, edhe pse publiku gjithnjë ka anuar ta përfytyrojë personazhin si negroid, pse kjo i përshtatet më mirë jetërsimit të tij të plotë në Venecia, ku një maur berber ase arab nuk do të ndihej përndryshe aq i huaj. Këtë edhe përkthimi i goditur i Nolit, i cili koincidon, ndër të tjera, edhe me dhënien e fjalës *moor* si *arap* në botimet e hershme të *Othello*-s në turqishte.

Në shqipen e sotme *arap*, së bashku me variantin dialektor *harap*, tingëllon pak e vjetëruar e folklorike, në një kohë që për brezat më të rinj mund të merret gabimisht edhe si një formë fonetike jostandard e fjalës tjetër *arab*, të leksikut të përgjithshëm. Mirëpo lidhja midis *arap* dhe *arab* duket kryesisht e natyrës etimologjike, meqë e para ka shenjuar rregullisht një person të racës së zezë, ose afrikan; ndërsa e dyta jo. Dihet edhe se *arap* e ka prejardhjen nga turqishtja dhe prej andej është përhapur në një numër gjuhësh, madje jo vetëm në Ballkan, dhe gjithnjë për të shenjuar zezakun². Arsyet për një rrëshqitje të tillë kuptimore kanë më tepër të bëjnë, nga njëra anë, me zakonet e përhapur shumë në trevat e Perandorisë Otomane për të pasur skllëvër zezakë dhe nga ana tjetër, me faktin që

këta skllëvër silleshin në trevat otomane prej tregtarësh arabë, çka i bënte njerëzit të supozonin njëfarë lidhjeje asociative midis Arabisë dhe racës së zezë. Arapi është jo vetëm fjalë e shqipes, por edhe personazh i njohur i përrallave dhe i mitologjisë popullore shqiptare dhe të vendeve të tjera ballkanike, duke përfshirë edhe Turqinë vetë. Sipas Robert Elsie, në këto përralla Arapi përshkruhet si lëkurëzi ose të paktën i zeshkët, dhe zakonisht i keq, edhe pse ndonjëherë bën mirë. Thuhet se Arapi nuk ka penis dhe se e ka lënë shpirtin në Çinamagin. Në përrallën e njohur “Arap Uzengjia”, Arapi e zhvesh lëkurën e zezë, për t’u zbuluar faqe botës si E Bukura e Dheut.³

Arap nuk është i vetmi emër etnik që ka përfunduar në personazh përrallash e mitesh shqiptare. Çabej, në një studim të hershëm, përmend ndër të tjera fjalën *Jelim*, që përdoret për të quajtur gjigantin në bregdetin e Jonit, e që e ka origjinën nga “helen”; fjalën *Xhudhi* që në Dukagjin përfytyrohet si qenie vigane e kohëve të para, e që lidhet drejtpërdrejtë me emrin e vjetër popullor (paraturk) të hebrenjve; fjalën *Gogë*, e cila fillimisht përdorej për të thirrur rumunët dhe arumunët, por tani shënjon edhe disa gjigantë dhe demonë të besimit popullor. Një tjetër figurë intriguese e mitologjisë përrallore është *Katallani*, i ngjashëm me Polifemin homerik dhe i përfytyruar si farkëtar trupmadh e trashaman, me një sy në ballë, pa gjunjë e me këmbë të drejta si dierek. Gustav Meyer-i, vëren Çabej, ka qenë i pari që e lidhi këtë figurë me kujtimin e një çete kalorësish gjakatarë nga Katalunja e Spanjës, të cilët i kish pajtuar si mercenarë



perandori bizantin Androniku II dhe që më pas u morën ca kohë me pirateri përgjatë brigjeve të Adriatikut⁴. Për të njëjtën arsye e sipas të njëjtit mekanizëm, Skënderbeu ka përfunduar si *Scannarebecco* në folklorin napolitan⁵, pas ekspeditave të tij, fitimtare por të përgjakshme, në ndihmë të mbretit Ferdinand I të Aragonës (ndoshta edhe nëpërmjet një rietimologjizimi, në bazë të afërisë fonetike me it. "scannare", ther).

Në një kuptim, shndërrimi që u bën psikologjia popullore këtyre kategorive reale në figura mitike e përrallash do marrë si pasojë e një mekanizmi për të zgjidhur disi ankthin e përballjes me të panjohurën, duke e përvetësuar këtë të panjohur në trajta rrëfimi qetësues. Procesi ka diçka të përbashkët me të menduarit magjik (paralogjik) dhe ndeshet rëndom në rrëfimetarë popullore. Nga ana tjetër, në rastin e popujve të dokumentuar relativisht vonë, si shqiptarët, folklori shërben edhe si depozitë faktesh historike përndryshe të harruara, të cilat gjithnjë presin të zbulohen nëpërmjet interpretimit. Lidhja midis Arapit si qenie mitike dhe skllëvërve afrikanë nga Nili i Epërm (Egjypt, Abisini dhe Sudan) në familjet e bejlerëve dhe të myslimanëve të pasur shqiptarë nuk vendoset dot lehtë edhe pse ekzistenca e këtyre skllëvërve dhe emërtimi i tyre si "arapë" njihen mirë. Që Arapi në përralla ndonjëherë përshkruhet si pa penis, kjo ndoshta ka të bëjë me faktin, përsëri të mirënjohur, që këta skllëvër ndonjëherë tridheshin para se t'i livroheshin konsumatorit (tredhja gjithnjë u besohej të krishterëve ose çifutëve egjiptianë, sepse feja Islame ua ndalon besimtarëve ta kryejnë edhe pse e lejon përdorimin e skllëvërve të tredhur. Tredhja e tipit *sandali* e praktikuar nga tregtarët e eunukëve konsistonte në amputimin e plotë të organeve gjinitale me një goditje të vetme të briskut, pas të cilit amputim futej me kujdes një pipëz e hollë prej kallaji ose plumbi në uretrën e viktimës, plaga kauterizohej me vaj të përvëlur dhe pacienti mbulohej me bajga të freskëta për t'u shëruar ose qetësuar⁶. Në raste të veçanta Arapi trupëzon reminishenca të periudhës paraosmane, si në vargjet e Fishtës "Kish' dalë një Harap prej detit/trim i zi e belaxhi..." (*Lahuta e*

Malsisë), të cilat njëfarësoj i referohen edhe *Bajlozit të zi* të këngës së Gjergj Elez Alisë, në Ciklin e Kreshnikëve, i cili njëlloj vjen prej detit për të plaçkitur trojet në brendësi. Të jetë fjala për një shembëllim të piratëve saraçenë që terrorizonin bregdetin arbëror gjatë shekujve kur Arbëria ishte pjesë e Perandorisë Bizantine?⁷ Apo për vasalët arabë të mbretit të Siçilisë Manfred Hohenstaufen, të cilët e ndihmuan këtë të fundit të ruante për ca kohë zotërimet e veta në Shqipëri prej Bizantit?

Edhe porti adriatikas i Ulqinit, jo larg arealit gjysmëmitik ku vepronte Gjergj Elez Alia, dëshmohej të ketë qenë objekt sulmesh nga piratët saraçenë që prej shekullit VIII, madje u mbajt edhe i pushtuar prej tyre për dy shekuj, para se t'u binte në duar sllavëve, venedikasve dhe në 1571 turqve otomanë. Deri në vitin 1878 qyteti mbeti një skelë e sigurt për piratët dhe vend i preferuar për zbarkimin dhe përpunimin e skllëvërve afrikanë, të cilët me kalimin e viteve filluan të martohen me shqiptarët vendas. Tregtia e skllëvërve vazhdoi edhe kur qyteti i kaloi Malit të Zi.⁸ Sipas studiuesit Alexander Lopashiç, një numër i konsiderueshëm i këtyre afrikanëve ose *arapëve*, vinin nga rajoni i Bagirmisë afër Liqenit të Çadit dhe flisnin si arabisht ashtu edhe një dialekt të sudanishtes⁹. Ky komunitet mulatësh myslimanë thuhet të ekzistojë në Ulqin edhe sot e kësaj dite. Dihet, nga ana tjetër, edhe se gjatë luftës otomano-veneciane të vitit 1686, trupat hanoveriane nën komandën e feldmarshallit Otho Königsmark që pushtuan për llogari të Venedikut fortesën otomane të Pylos-it në Morenë perëndimore gjetën atje një garnizon të përbërë kryesisht prej zezakësh, të cilët u dorëzuan pa luftë dhe u çuan pastaj në Aleksandri të Egjiptit. Pak javë më vonë, venedikasit iu kapën otomanëve edhe fortesën tjetër të Modonit përsëri në More, duke

siguruar ndër të tjera edhe 400 skllëvër zezakë si plaçkë lufte¹⁰. Kjo dëshmon më tej hipotezën për një prani sado të kufizuar lëkurëzinjsh afrikanë në brigjet perëndimore të Ballkanit. Edhe përfundimet skandaloze të studimit të shumëpërfolur të Arnaiz-Villena et al.¹¹



për lidhjet gjenetike specifike të grekëve të sotëm me popullsinë sub-sahariane (negroide) në Afrikë, ndoshta mund të shpjegoheshin me këtë infuzion të vonë ose mesjetar në kontingjentin e testuar prej tyre, të elementit zezak afrikan sjellë nga arabët dhe otomanët si skllavër në portet greke të Egjeut, Mesdheut dhe Jonit, gjatë periudhës së sundimit otoman. Personalisht, dhe për aq sa mund të vlejë kjo dëshmi anekdotike, kam njohur shqiptarë myslimanë të bregdetit jugor të Shqipërisë (nga Borshi deri në Butrint) që, po të mos e dija se ishin prej andej e po të mos i dëgjoja të flisnin shqip, do t'i kisha menduar menjëherë si mulatë-afrikanë të zinj për nga tiparet fizike.

Në rrjedhë të historisë, shqiptarët janë takuar me

zezakët nga Afrika vetëm marginalisht, në periferi të perandrive dhe siç ndodh në raste të tilla, gjurmët e këtyre takimeve kanë përfunduar të transformuara thellë në folklor dhe në gjuhë. Trajtimi i figurës së Arapit në kujtesën kolektive të shqiptarëve dëshmon për një orvatje *in extremis* për ta zgjidhur disi problemin e jetërsimit, përballë një qenie të perceptuar njëkohësisht si njeri dhe si jonjeri. Nga ana tjetër, dëshmitë e shumta të pranisë së skllavërve afrikanë në brigjet shqiptare të Ballkanit, ndonjëherë edhe në numër të madh, hapin një dritare të nevojshme në të kuptuarit e dinamikave demografike dhe etnike përgjatë vijës bregdetare banuar prej shqiptarëve, gjatë periudhës otomane.

Shënime

1. Në mos gabohem, në përkthimin shqip të romanit *Robinson Crusoe* prej Halit Selfos e Bujar Dokos, thuhet se heroi bie në duar të "maurëve".

2. Arap ishte edhe Ibrahim Petrovich Gannibal, stërgjyshi afrikan i Pushkinut sjellë në Rusi si skllav nga Pjetri i Madh dhe që pastaj bëri karrierë si major-gjeneral dhe guvernator i një province të perandorisë; të cilit poeti rus i kushtoi prozën e papërfunduar *Arap Petra Velikogo*.

3. Elsie, R., *A Dictionary of Albanian Religion, Mythology, and Folk Culture*, NY University Press, 2001, ff. 13-14

4. Çabej, E. "Disa figura të besimeve popullore shqiptare," *Gjurmime albanologjike*, Nr. 2/Prishtinë, 1972.

5. "La fiaba dell'orco" ose "Përralla e bubës" në versionet e veta të ndryshme. Ja teksti i një përshkrimi të bubës ("orco"), në një version të mbledhur në Campi Flegrei, afër Napolit: "Era chisso naimuozzo e strappone de fescina, aveva la capo cchiù grossa che na cocuzza d'Innia, la fronte vrogolosa, le ciglia jonte, l'uecchie strevelate, lo naso ammaccato co doje forge che parevano doi chivache maestre; na vocca quanto no parmiento da la quale scevano doi sanne che l'arrivavano all'ossa pezzelle; lo pietto peluso, le braccia de trapanaturo, le gamme a bota de lamia e li piede chiatte comme a na papara. Nsomma, pareva no racecotena, no parasacco, no brutto pezzente e na mal'ombra spiccecata, c'averria fatto sorrejere n'Orlanno, **atterrire no Scannarebecco** e smajare no fauza pedata." Në këtë përrallë, buba përshkruhet aq i frikshëm e i llahtaritur, sa deri edhe "Skënderbeun do ta kishte tmerruar". Marrë nga http://www.quicampiflegrei.it/rubriche/campania_20.htm

6. Cituar sipas <http://www.allaboutturkey.com/harem.htm>

7. Një fakt pak i përmendur në historitë e shqiptarëve gjatë mesjetës është roli i piraterisë në shpërndarjen e popullsisë në trojet e atëhershme. Në të vërtetë vija bregdetare e Adriatikut dhe e Jonit i ka vuajtur shumë sulmet e piratëve saraçenë sa kohë që kjo vijë kontrollohej pak a shumë nga bizantinët ose nga Venediku; katolikë, p.sh. të Urdhrit të Maltës, ose uskokë dalmatë, kur zonën e pushtuan otomanët. Piratët zakonisht sulmonin rrufeshëm qytezat bregdetare, për të bërë plaçkë e për të kapur skllavër, të cilët i shisnin pastaj gjetiu me fitime të mëdha. Kaq shkatërruese ishte pirateria për bregdetin arbëror dhe epirot të asaj kohe deri poshtë në Morë, sa efektet e saj i sheh edhe sot, në mënyrën si është i populluar ky bregdet, me pak qytete relativisht të mëdha e të fortifikuara, por fare pak fshatra. Himara mesjetare përfaqëson një shembull tipik të një komuniteti të lidhur ngushtë me detin, por njëkohësisht të detyruar të fortifikohet në majë të malit, për t'u mbrojtur nga sulmet e papritura të piratëve. Përndryshe, bregdeti shqiptar paraqitet sot me një numër qytetesh të vjetra si Vlora, Durrësi, Ulqini të ndara mes tyre nga plazhe, zona kënetore, pyje të degraduara e djerrina të pabanuara; megjithë përparësitë ekonomike të vetëkuptueshme që do të kishte një vendbanim afër detit.


8. Norris, H.T., *Islam in the Balkans*, University of South Carolina Press, 1993, ff. 206.

9. Lopasic, A., "A Negro Community in Yugoslavia", *Man*, vol. LVIII, Nov.1958, f. 171, me literaturë.

10. Finlay George, *The History of Greece under Othoman and Venetian Domination*, 2005 Adamant Media Corporation, ff. 215-216.

11. Arnaiz-Villena et al., "HLA genes in Macedonians and the sub-Saharan origin of the Greeks", *Tissue Antigens*, 2001. Artikulli mund të lexohet në <http://www.makedonika.org/processpaid.asp-contentid=ti.2001.pdf>

NILES ELDREDGE: “TË SHPËTOJMË PLANETIN NGA KATASTROFA NJERËZORE”



Binomi njeri-mjedis në më të shumtën e rasteve nuk është konsideruar si një ndërveprim reciprok por jetohet si dy njësi të ndara ku njeriu do gjithmonë të kryesojë.

“Çdo vit zhduken 30 mijë specie të gjalla: më e shpejta në historinë e Tokës. Ne njerëzorët jemi më shkatërrues se kataklizma që shfarosi dinosaurët. E unë dua që njerëzit ta kuptojnë këtë gjë duke shpresuar që ta ndojnë detyrën për të bërë diçka” – flet me vendosmëri paleontologu amerikan Niles Eldredge.

Publiku i gjerë e njeh sidomos për miqësinë e tij me Stephen Jay Gould, studiuesi i evolucionit që vdiq kohët e fundit, me të cilin ai përpunoi tridhjetë vjet më parë teorinë e ashtuquajtur e “ekuilibre të pikëzuar”. Ky ishte një interpretim modern i darvinizmit që konsideron evolucionin jo një proces gradual por një alternim të periudhave të gjata qendrueshmërie të ndjekura nga faza ku faktorë të ndryshëm sidomos mjedisorë shkaktojnë zhdukjen e disa specieve dhe favorizojnë lindjen e specieve të reja. Por Eldredge është edhe krijuesi i Hall of Biodiversity, një ekspozitë e përhershme mbi shumëllojshmërinë e formave të jetës dhe rreziqeve që e kërcënojnë, në Muzeun Amerikan të Historisë Natyrore.

Profesor Eldredge, libri juaj i fundit kërkon të ndërtojë një dialog midis disiplinave të ndryshme...

Eshtë e domosdoshme nëse duam me të vërtetë të kuptojmë si ka evoluar jeta në planetin tonë: problemi qendron se universi dhe krijesat që e popullojnë rregullohen nga ligje më komplekse se sa ato që u pëlqejnë shumë shkencëtarëve.

Një përshkrim që të çon në mendje hipotezën e vjetër “Gaia”, të propozuar nga James Lovelock e Lynn Margulis, që e shihte tokën si një sistem i vetëm fiziologjik.

Nuk bashkëndaj një këndvështrim të tillë kaq radikal, por nëse përdorim termin Gaia për të kujtuar se të gjithë ekosistemet janë të ndërlikur midis tyre e që ne ndodhemi brenda një sistemi kompleks energjetik global ku bën pjesë edhe jeta, nuk mund të mos ta pranojmë. Problemi është se sot asnjë studiues, sado i shkëlqyer të jetë, nuk mund të ndjekë personalisht progresin e gjithë disiplinave të ndryshme për të kryer këtë lloj sinteze.

Eshtë kjo një kritikë ndaj reduksionistëve si Richard Dawkins?

Të pohosh siç bën Dawkins se evolucioni i shërben vetëm gjeneve për të riprodhuar veten është sikur të thuash se projekti për ndërtimin e një automobili është më i rëndësishëm se vetë automobili. Po përfundoj së shkruari një ese të titulluar *Why people have sex, and other mysteries* pikërisht për të kujtuar se nuk jemi në këtë botë vetëm për të bërë fëmijë, siç mendojnë Kisha dhe biologët evolucionistë, e që riprodhimi rregullohet edhe nga faktorë të tjerë. Pa marrë parasysh se disa specie, si ajo njerëzore p.sh., nuk bëjnë seks vetëm për qëllim riprodhues.

Ju keni braktisur studimet mbi fosilet për t'iu dedikuar problemeve me vështirësi më të gjerë si biodiversiteti apo eksplodimi demografik. Çfarë ju ka shtyrë?

Situata urgjente në të cilën jetojmë. Është tepër e rëndësishme të merren masa drastike, për të ndaluar zhdukjen e shumë specieve, gjë që mund të ketë pasoja shumë të rënda si nga pikëpamja mjedisore ashtu edhe nga ajo evolutive. Të zgjidhim problemet jetësore si mungesa e ujit të pijshëm, ndotja e lumenjve dhe oqeanëve që po shkatërrojnë rezerva të çmuara. E mbi të gjitha le të pyesim veten: sa banorë mund të mbijetojnë në këtë planet? 10 mijë vjet më parë, kur filloi zhvillimi i bujqësisë, toka ish e populluar nga gjashtë milionë njerëz, sot jemi gjashtë miliardë.

Kemi arritur kulmin?


Është llogaritur se në tokë mund të mbijetojnë 13 miliardë njerëz. Natyrisht, varet se ç'kuptojmë me mbijetesë: nëse mendojmë për nivelin e jetesës së një amerikani të mesëm, edhe gjashtë miliardët aktuale janë tepër.

Megjithatë ka edhe sinjale pozitive: në disa vende, rritja e popullsisë ka ndaluar – dhe plakja e saj nxjerr probleme të reja. Edhe në vende si India lindjet po zvogëlohen falë përmirësimit të kushteve të jetesës dhe arsimimit sidomos të grave.

Po në Shtetet e Bashkuara?

Politika jonë mjedisore është shumë dritëshkurtër. Por nuk ke pse habitesh kur dihet që vendin e qeverisin shoqëritë e mëdha të naftës.





Këndi i librit

DHJETE FYTYRAT E INOVACIONIT

Autor: Tom Kelley

ISBN: 0385512074

Në ndërmarrje të ndryshme figura e avokatit të djallit është sot më aktive se kurrë: kushdo që merr këtë rol ndihet i autorizuar që të krijojë dyshime apo preokupime që çojnë në mbyajtjen e projekteve dhe ideve të reja origjinale duke evituar çdo përgjegjësi personale. E nuk ka gjë më të keqe për të dekurajuar krijimtarinë.

Gjatë viteve, IDEO, shoqëri projektimi që nxit përhapjen e mendimit inovator në ndërmarrje të ndryshme, ka përcaktuar dhjetë role që secili mund t'i interpretojë në organizime të çfarëdo lloji për të favorizuar lindjen dhe zhvillimin e ideve të reja, e në të njëjtën kohë të neutralizojë ata që mbjellin dyshime.

Ndër ta është edhe antropologu, personazh që shkon në bazë për të vëzhguar se si klientët përdorin produkte të ndryshme dhe reagojnë ndaj tyre; prej këtej ai gjen ide për mundësi inovacioni. Më tej kemi pjalmuesin transversal që kombinon e krahason detaje të ndryshme, persona e teknologji për t'iu dhënë jetë ideve të reja që mund të stimulojnë zhvillimin. Kapercyesi i pengesave impenjohet menjëherë për të gjetur mënyrën për të mėnjanuar apo kaluar problemet dhe sfidat gjithmonë të pranishme në çdo situatë...

I pasur me rrëfime që tregojnë se si ndërmarrje të çdo tipi – nga Kraft tek Procter&Gamble, nga Safeway tek Samsung – kanë përvetësuar mendimin e IDEO-s për të kthyer në dobi përvojën e klientëve të tyre. "Dhjetë fytyrat e inovacionit" është një udhëzues për të ushqyer e mbështetur kulturën e vazhdueshme të rinovimit.

Siguria si konstruksion shoqëror: pasiguria si kusht i domosdoshëm për sigurinë

Security as a social construction: insecurity as a necessary condition for security

1. Hyrje

Shumë ngjarje dhe përshkrime bashkëkohore krijojnë një përshtypje të përgjithshme të ankthit dhe të pasigurisë tek shumica e njerëzve. Pas Luftës së Ftohtë, rreziqet e sigurisë u paraqitën si kërcënime nga armiq të shumëllojshëm dhe paaftësia për t'i renditur sipas masës së rrezikshmërisë vazhdon të ushqejë këtë klimë kaosi dhe ankthi të gjithanshëm. Çështjet e sigurisë janë të pranishme kudo dhe kjo shihet edhe nga fryrja e masave të sigurisë. Por se çfarë kuptohet me 'siguri' është më pak e qartë, aq më tepër kur përkufizimi i sigurisë kushtëzohet nga motivet që kërkohen. Analizimi i logjikës dhe përbërësve të sigurisë është i domosdoshëm për të kuptuar se si (keq)përdoren përpjekjet për 'siguri'. Në dukje, klima e ankthit dhe e papërcaktueshmërisë vetëm gërryen legjitimitetin e shtetit apo të instancave të përgjegjshme 'për të vënë nën kontroll gjendjen', por në realitet, është pikërisht kjo gjendje pasigurie dhe ankthi që përbën burimin kryesor të legjitimitetit dhe të vetë ekzistencës së shtetit¹.

1.1. Një këndvështrim konstruktivist

Në mënyrë që të shtjellojmë çështjen e sigurisë, del i nevojshëm huazimi i një këndvështrimi teorik. Kjo teori nuk shërben vetëm si një model me hipoteza dhe premisa, por edhe si instrument thjeshtëzues që lejon përzgjedhjen e fakteve të dobishme dhe të rëndësishme për të kuptuar një çështje ndërkombëtare si siguri. Këndvështrimi konstruktivist nuk synon të mbrojë apo provojë vërtetësinë e premisave të saj, por shërben si një instrument i volitshëm për të vënë në pah natyrën e procesit shoqëror dhe politik të sigurisë, ndërkohë që teoritë e tjera mbi marrëdhëniet ndërkombëtare nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur².

Faktorët ndikues mbi sjelljen e shteteve kanë dominuar gjatë debatin ndërmjet teorive kryesore si realizmi, liberalizmi dhe së fundmi konstruktivizmi. Debat bashkëkohor përqendrohet në ndikimin e strukturës (anarkisë) dhe proceseve (shoqërizimit ndërmjet ndërveprimit) në sjelljen e shteteve³. Edhe pse kanë dallime domethënëse, variantet e reja të dy teorive të para, neo-realizmit dhe neoliberalizmit, ky debat bazohet në

premisën e përbashkët të (meta)racionalizmit⁴. Për të dyja palët, shtetet janë aktorët kryesorë në sistemin ndërkombëtar të cilët veprojnë në mënyrë racionale për të përmbushur interesat kombëtare duke synuar sa më shumë fuqi dhe siguri, gjithmonë duke përkufizuar sigurinë në varësi të interesave të ngushta vetjake. Interesat dhe identitetet e aktorëve ndërveprues janë të dhëna (nga jashtë), të cilat mbeten të palëvizshme edhe nëse shtetet ndryshojnë sjelljen e tyre. Duke qenë se shtetet janë të dënuar të funksionojnë në një gjendje anarkie (*Hobbsiane*) atëherë ata janë të detyruar të veprojnë sipas interesave të tyre egoiste për të mbijetuar. Ky pohim thelbësor krijon një dinamikë konkurruese të dilemës së sigurisë⁵ dhe problemit të bashkëpunimit⁶. Sipas këtij botëkuptimi thellësisht pesimist fuqia, e matur kryesisht me kapacitetin ushtarak dhe përpjekjet për siguri, janë forcat kryesore në politikën botërore. Mësimi që mund të nxjerrim nga realistët është "Gjithsecili për vete, askush për të gjithë"; "Jeto në akth, dysho gjithçka" dhe "Bëhuni gati për më të keqen se dikur ka *mundësi* të ndodhë"⁷.

Konstruktivistët sjellin një kuptim krejtësisht të ndryshëm të politikës botërore dhe sfidojnë kështu shpjegimet e sipërpërmendura për përkufizim⁸. Përqasja e tyre epistemologjike përqendrohet në konstruksionin shoqëror të kuptimeve/dijes së përbashkët dhe mbrojnë një pohim ontologjik që thekson konstruksionin shoqëror të realitetit. Gjithashtu, theksojnë ndërlidhjen reflektive midis konstruksionit të dijes dhe konstruksionit të realitetit shoqëror⁹. Pohimi kryesor që kuptimi dhe si rrjedhojë dija, është konstruksion shoqëror, bazohet në parimin e dijes ndërsjelltë¹⁰. Faktorët ideore jo-materialë të realitetit, si kuptimet dhe dija e përbashkët, vlerat, normat, parapritjet, janë pjesë për-



bërëse e botës konkrete dhe janë të domosdoshme për të kuptuar dhe shpjeguar sjelljen e shteteve¹¹.

Njerëzit reagojnë kundrejt objekteve apo aktorëve të tjerë bazuar në kuptimin që këta objekte apo aktorë kanë për to. Qëndrimi i ndryshëm ndaj miqve dhe armiqve krijon dhe parapritje të ndryshme: armiq të përjetohen si të rrezikshëm ndërsa miqtë jo. E njëjta gjë vlen dhe për ndërveprimet midis shteteve. Fuqia amerikane përjetohet ndryshe nga Kanadaja sesa nga Kuba. Arsenali bërthamor britanik përjetohej ndryshe nga ai sovjetik.¹² Ky pohim fundos pretendimin realist se shtetet janë në garë për balancimin e fuqisë: shtetet balancojnë kundrejt rreziqeve (të krijuara). Potencialet bërthamore kanë ende te njëjtën rrezikshmëri por nuk ngjallin të njëjtin rrezik si gjatë kohës së Luftës së Ftohtë, çka dëshmon se struktura e ndërveprimit nuk është e dhënë por e ndryshueshme në varësi të veprimeve të aktorëve: “[...] *social structure exists, not in actor's heads, nor in material capabilities, but in practices. Social structure exists only in process. The Cold War was a structure of shared knowledge that governed great power relations for forty years, but once they stopped acting on this basis, it was "over"*” (Wendt, 1995, 74). Kapacitetet (ushtarake dhe ekonomike) të shteteve janë konkrete dhe vendimtare në përlogaritjet strategjike të tyre, por mënyra se si përdoren dhe bëjnë kuptim përcaktohet nga norma, ide, vlera dhe parapritje të përbashkëta, të cilat krijojnë koncepte të vetes dhe parapritje ndaj të tjerëve¹³.

Janë pikërisht kuptimet e përbashkëta ato që krijojnë strukturën në të cilën organizojmë veprimet tona. Si njësi ndërtuese të këtyre kuptimeve të përbashkëta aktorët përvetësojnë identitete të caktuara, në varësi të kapaciteteve përkatëse. Identitetet janë të nevojshme për të siguruar një shkallë minimale përcaktueshmërie dhe parashikueshmërie të aktorëve ndërveprues. Ato na bëjnë të ditur neve dhe të tjerëve se ‘kush jemi’ dhe na tregojnë se ‘kush janë’ të tjerët¹⁴. Identiteti përcakton rolin e aktorit dhe si rrjedhojë përbën bazën e interesave¹⁵. Identitetet dhe natyra e aktorëve janë të ndryshueshëm, si rrjedhojë interesat e më pas edhe sjellja që varet nga këto interesa.

Veprimet e aktorëve gjejnë kuptim vetëm nëpërmjet procesit të ndërveprimit me aktorët e tjerë. *Procesi* i ndërveprimit midis shteteve është thelbësor për faktin se përcakton veprimet e tyre dhe i vesh ato me kuptime të caktuara. Kjo gjendje është kryesisht një fenomen ndërsubjektiv, produkt i veprimeve dhe parapritjeve të ndërveprimit midis aktorëve. Rrjedhimisht, anarkia ka kuptim vetëm në sajë të kulturës, normave, institucio-

neve, procedurave dhe praktikave shoqërore që i japin kuptim kësaj gjendjeje¹⁶. Janë *proceset* dhe parapritjet apo idetë që kanë aktorët ndërveprues ndaj njeri-tjetrit që krijojnë anarkinë dhe ‘logjikën’ e saj¹⁷. Prirja natyraliste e realistëve që pretendojnë të njohin botën ‘sikur është në realitet’, e pandryshueshme, historikisht ciklike dhe ku sundon ligji i xhunglës, bëhet një përshkrim i saktë i sistemit ndërkombëtar *vetëm* nëse besohet si i tillë nga shtetet¹⁸.

Janë parapritjet që ushqejnë aktorët kundrejt njëri-tjetrit ato që krijojnë një klimë ku mund të sundojë mosbesimi dhe fryma armiqësore ose mirëbesimi dhe fryma paqësore. Gjendja e sotme e sistemit ndërkombëtar është një parashikim vetëkonfirmues¹⁹. Spekulimi se feja dhe ndasi të tjera të thella midis qytetërimeve do të përbejnë burimin dhe vijat e konflikteve të ardhshme ndërkombëtare – edhe pse bazohet në kritere tepër përgjithësuese dhe thjeshtëzuese të realitetit botëror²⁰ – do të bëhet i pashmangshëm *vetëm* nëse të gjithë njerëzit e marrin si të qenë dhe veprojnë sipas ‘logjikës’ së tij²¹.

Procesi diskursiv që krijojnë këto identitete dhe perceptime të ‘vetvetes’ dhe të ‘tjerëve’ janë thelbësore për vetë përkufizimin dhe përbërjen e sigurisë: *‘Processes of identity-formation under anarchy are concerned first and foremost with the preservation or “security” of the self. Concepts of security therefore differ in the extent to which and the manner in which the self is identified cognitively with the other’* (Wendt, 1992, 399).

2. Siguria dhe konstruksioni i ‘tjetrit’ (të rrezikshëm) si domosdoshmëri jetike

Përshkrimi dhe konstruksioni i realitetit është i lidhur në mënyrë të pandashme me pushtetin dhe politikën. Aftësia për të përcaktuar gjendjen dhe për të përkufizuar rreziqet që i kanosen sigurisë së shoqërisë është një shprehje fuqie. Përkufizimi i sigurisë nënkupton në rradhë të parë përcaktimin e kufijve ndërmjet ‘bashkësisë së vetes’ dhe ‘bashkësive të të tjerëve’. Një klasifikim i tillë tregon se ‘kush është kundra nesh’ por dhe ‘kush jemi ne’. Përkufizimi i konceptit të ‘sigurisë’ përbën në vetvete një rrezik, jo vetëm për zgjerimin e saj edhe në sferat më intime të jetës shoqërore gjë që rrezikon të prodhojë më tepër pasiguri²², por veçanërisht sepse është një koncept i ngarkuar ideologjikisht, çfarë e bën një koncept të diskutueshëm dhe që mund të marrë trajta nga më të ndryshmet. Prandaj dhe interpretimet e ‘sigurisë’ janë për përkufizim të ndryshme²³.

Kuptimi i sigurisë nënkupton një mënyrë të caktuar të

organizimit të marrëdhënieve shoqërore. Për Huysmans, mënyra kulturore se si trajtohet vdekja përbën bazën e sigurisë²⁴. Përpjekjet për siguri, janë përpjekje për mbijetesë²⁵. Kjo pikënisje është e vlefshme si për sigurinë ontologjike, që ka të bëjë me kaosin dhe rendin e përgjithshëm, ashtu dhe për sigurinë e përditshme, që ka të bëjë me marrëdhëniet miq/armiq. Në një gjendje natyrore ku sundon kaosi, njerëzit bashkohen në grupe për tu mbrojtur nga grupe të tjera. Aftësia për të klasifikuar dhe identifikuar rreziqet zbut disi ankthin e pasigurisë dhe të papërcaktueshmërisë kërcënuese. Pikërisht në procesin e identifikimit dhe përkufizimit të këtyre rreziqeve fshihen rreziqet e sigurisë që mund të shkaktojnë më tepër pasiguri.

Sipas Waevers²⁶, siguria mund të trajtohet si një shprehje diskursive, gjuhësore. Shprehja është njëkohësisht vetë shtjellimi i saj²⁷. Në thelb, siguria është një konstruksion shoqëror që merr një kuptim të caktuar vetëm brenda një konteksti shoqëror të caktuar. Krijohet dhe ndryshon në saje të diskursit që synon të riprodhojë struktura historike dhe subjekte brenda dhe ndërmjet shteteve. Është e qartë që politikëbërësit bazojnë përcaktimin e sigurisë mbi supozime të caktuara në mbrojtje të interesave jetike të tyre kundrejt armiqve dhe rreziqeve të mundshme, por këta të fundit nuk kanë ndonjë shtrirje 'objektive' të pavarur nga konstruksionet shoqërore.

Fakti që siguria është një konstruksion shoqëror, siç kritikohet me të drejtë²⁸ nuk do të thotë se nuk mund të gjenden kushte konkrete që ndihmojnë në krijimin e një interpretimi të caktuar të rreziqeve, armiqve apo që këto kushte nuk bëjnë pjesë në krijimin e supozimeve ku bazohet politika e sigurimit të një shteti të caktuar. Por siç është përmendur më lart, për një pjesë domethënëse, armiqtë 'krijojnë' njëri-tjetrit si rezultat i parapritjeve më armiqësore për njëri-tjetrit dhe marrëdhënia e tyre në këtë aspekt është ndërsujektive. Në varësi të brendësismit të këtyre parapritjeve ndërsujektive, rreziku i perceptuar kundrejt njëri-tjetrit përvetëson një karakter konkret²⁹. Rrjedhimisht, nëse njerëzit përcaktojnë situata të caktuara si konkrete, atëherë ato janë konkrete edhe në pasoja³⁰. Shembulli që sjell Lipschutz e ilustron shumë qartë këtë gjendje: *"Nuclear deterrence depended on lines on the ground and in the mind: To be secure, one had to believe that, were the Other to cross the line, both the self and the Other would cease to exist. The threat of nothingness secured the ontology of being, but at great political cost to those who pursued this formula. Since 1991, deterrence has ceased to wield*

its cognitive force, and the lines in the mind and on the ground have vanished [...]" (Lipschutz, 1998, x).

Rreziqet apo kërcënimet nuk mund të ekzistojnë nëse nuk përkufizohen. Klasifikimi i problemeve të caktuara në kategorinë e çështjeve të sigurisë shpie në "sigurizimin" e tyre (koncept i sjellë nga Shkolla e Kopenhagenit), që nënkupton justifikimin e masave të jashtëzakonshme për tu bërë ballë. Që një problem të shtrohet si çështje sigurie, që të 'sigurizohet', duhet që të paraqitet si një rrezik ekzistencial që justifikon një veprim të shpejtë, masa të jashtëzakonshme dhe duhet të pranohet si përshkrim i qenë nga një shumicë domethënëse. Diskursi, praktika gjuhësore dhe jo gjuhësore krijojnë atë çfarë merret si siguri apo pasiguri. Rrjedhimisht, siguria nuk ka kuptim të palëvizshëm: siguria është gjithçka e cila paraqitet si e tillë.

Koncepti i "sigurizimit" ka një rëndësi themelore, sepse sfidon idenë e identiteteve të palëvizshme dhe thelbësore. Konsolidimi i 'vetes' dhe 'tjetrit' janë jetike në këtë proces. Mënyra e përcaktimit të sigurisë është thelbësore sepse zakonisht përcaktohet si siguri e 'vetes' kundrejt të 'tjerëve'. Qenia e një tjetri (të rrezikshëm) është kusht jetik për vetë krijimin e identitetit dhe legjitimitetin e një grupi shoqëror-politik. Nëse nuk ka një 'tjetër' të rrezikshëm dhe kërcënues, nuk ka burim për legjitimitetin e shtetit dhe as të bashkësisë shoqërore.

Sipas Dillon³¹, shoqëria jo vetëm që përballet me rrezikun, por është e ndërthurur me atë dhe përbën vetë kushtin e ekzistencës së saj. Thelbi i çështjes mbi sigurinë përbëhet nga domosdoshmëria e armiqve për të legjitimuar pushtetin dhe vetë ekzistencën kundrejt të 'tjerëve'. Campbell³², gjithashtu vë në pah domosdoshmërinë e tjetrit të rrezikshëm, për të krijuar dhe ruajtur vetë legjitimitetin e shtetit. Në analizën e politikës amerikane gjatë Luftës së Ftohtë, ai vë në pah se si perceptimet e rreziqeve dhe dallimet (kulturore) bashkërendohen në krijimin e një identiteti të caktuar. Ai parashtrohet se si politika e jashtme ndërton identitetin e shtetit nëpërmjet interpretimit të rrezikut të kanosur nga të tjerët.

Frika dhe ankthi, jo vetëm që përzihen me krijimin e sigurisë dhe të vetvetes, por janë pjesë integrale e këtij projekti. Ndërlidhja midis identitetit, frikës dhe sigurisë është e pandashme. Campbell dëshmon gjithashtu domosdoshmërinë për një tjetër të rrezikshëm pas fundosjes së Bashkimit Sovjetik që shërbente si rrezik i përbashkët, kryesisht për demokracitë liberale. Regjimet diktatoriale 'jo-legjitime', terrorizmi, emigracioni

përmbushin këtë funksion pas Luftës së Ftohtë. Mutimer³³ gjithashtu, thekson rëndësinë e rolit të identitetit dhe të dallimeve (kulturore) dhe si këto dallime shndërrohen në tjetër të rrezikshëm si një domosdoshmëri jetike politike³⁴. Për SHBA-në, zhdukja e Bashkimit Sovjetik si rrezik lehtësisht i identifikueshëm, krijoi një problem thelbësor për përcaktimin dhe legjitimimin e rolit të saj ndërkombëtar. Ndër të tjera, mungesa e një 'tjetri' të rrezikshëm dhe kërcënues do ta bënte të pamundur (për Pentagonin) justifikimin e vazhdimësisë së shpenzimeve ushtarake (në rritje).

Kategoria e rreziqeve të reja përmbush një funksion ekzistencial të tjetrit të rrezikshëm që justifikon marrjen e masave të jashtëzakonshme, deri në përdorimin e dhunës ushtarake në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Me ardhjen në pushtet në vitin 2000 të klanit neo-konservator, të kryesuar nga Rumsfeld dhe Cheney³⁵, evidentimi i rreziqeve ishte jetik për justifikimin e përdorimit të fuqisë amerikane për të vënë në jetë projektin e tyre revolucionar për përhapjen e demokracisë liberale, veçanërisht në Lindjen e Mesme, për të siguruar mirëqenien dhe sigurinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Me gjithë arritjet simbolike, në mënyrë të përgjithshme përpjekjet për t'u bërë ballë këtyre rreziqeve të paraqitura duke justifikuar 'masa të jashtëzakonshme', kanë çuar në cungimin, në rradhë të parë, të të drejtave kushtetuese të qytetarëve amerikanë dhe kanë përkeqësuar gjendjen në botë, sidomos në Irak. Mënyra e tyre e politikëbërjes, ka përçarë aleatët e natyrshëm, ka marginalizuar shumicën dërrmuese të moderuar duke iu dhuruar legjitimitet forcave pafundësisht regresive dhe ekstremiste në Irak dhe gjatë që për përkufizim janë në kundërshtim me interesat amerikane dhe vlerat e demokracisë liberale³⁶. Pasojat rrënuese të kësaj politike tashmë nuk mund të mohohen as nga mbrojtësi i zjarrtë i projektit të neo-konservatorëve Fukuyama³⁷.

E njëjta logjikë e "tjetrit" ka ngërthyer edhe veprimtarinë e NATO-s, që pas shkatërrimit të Bashkimit Sovjetik humbi arsyen e ekzistencës së saj dhe që tani përpiket të përshtatet dhe të ripërkufizojë 'veten' duke ndërtuar të 'tjerë' të rinj, për të legjitimuar ekzistencën e saj³⁸. Emigrantët shërbejnë gjithashtu si tjetri i shoqërive perëndimore dhe i vendeve të tjera të 'qendrës'³⁹. Edhe pse janë një rrezik i brendshëm, ata përjashtohen nëpërmjet anëtarësimit në shoqëritë përkatese duke i paraqitur si armiqësorë dhe të rrezikshëm. "Sigurizimi" i emigracionit shtyhet nga përpjekjet për të mbrojtur identitetin dhe mirëqenien shoqërore. Nën

ndikimin e mitit politik të homogjenitetit të perëndimit, i propaganduar sidomos nga retorika e forcave të djatha dhe populiste, emigrantët dhe dallimet kulturore paraqiten si rrezik për stabilitetin e shoqërisë. Retorika, diskursi politik dhe media, që me ndonjë përjashtim të rrallë, mund të përshkruhet si industria e prodhimit dhe përpunimit të realitetit, përforcojnë këtë paraqitje të këtij 'tjetri' të rrezikshëm dhe ushqejnë ndjenja të ankthit të përgjithshëm tek shumica e njerëzve.

Përderisa 'siguria' nuk përshkruan marrëdhëniet shoqërore por i shndërron ato në marrëdhënie sigurie, pyetja atëherë nuk shtrohet nëse marrim një pamje të saktë apo të rreme të marrëdhënieve shoqërore. Pyetja është se si fenomeni i sigurisë rregullon këto marrëdhënie dhe cilat janë pasojat e fenomenit të 'sigurizimit'. Huysmans e përshkruan këtë gjendje si paradoksin e sigurisë, ku pasiguria është kusht i domosdoshëm për sigurinë: *'[...] our political identity rely on the threatening force of the other; nevertheless security policy aims ideally at eliminating this threat; if the threat were really eliminated, the political identity would be damaged and, depending on how strongly it relies on the threat, it may very well collapse'* (Huysmans, 1998, 239).

Në vend të përfundimeve mund të thuhet se ekzistenca e pasigurisë, një shkallë papërcaktueshmërie dhe ankthi, është domosdoshmëri politike për përvetësimin e legjitimitetit të bashkësive shoqërore dhe vetë shtetit. Procesi i konstruksionit të sigurisë dhe domosdoshmëria për një tjetër të rrezikshëm turbullon atë që është realisht e rrezikshme e duhet të luftohet dhe çfarë paraqitet si e tillë por, që në të shumtën e rasteve nuk përputhet me realitetin; ose veprimi ndaj tyre është jashtë proporcioneve.

Siguria ka një natyrë më tepër psikologjike sesa konkrete; ka të bëjë me ndjenjën sesa të qenit të sigurt. Edhe në kushte normale, të gjithë njerëzit janë të zhveshur nga ndikimet indoktrinuese që shtrembërojnë kuptimin e realitetit. Kur fushata e keqinformimit bëhet qëllim në vetvete, atëherë bëhet fjalë për trushpëlarje të njerëzve, saqë botëkuptimi i tyre merr trajtat më mramendëse të paarsyetimit të cilat lenë shteg për krijimin e paranojës dhe ankthit⁴⁰. E njëjta logjikë shpjegon mënyrën se si ushqehet ndjenja e frikës që i bën njerëzit të ndihen të pasigurtë edhe për një rrezik që nuk ekziston.

Në kundërshtim me ndjenjën e pasigurisë së përgjithshme globale, studimet e shumta tregojnë se prirjet vazhdojnë të jenë pozitive. Ka më pak luftëra dhe rrezik për luftëra në të ardhmen. Ka më pak diskriminim dhe dhunë etnike. Shtetet demokratike sa vijnë dhe

shtohen⁴¹. Rreziku ndaj terrorizmit apo sulmeve terroriste (bërthamore) është në shkallën më të ulët ndonjëherë, por ngaqë është e pamundur të hidhet poshtë, mundësia e një sulmi të tillë shërben si një lubrifikant i fuqishëm për politikën e 'masave të jashtëzakonshme'. Që *mundësia* nuk mund të nënkuptojë probabilitet është e qartë. Që rreziku nga terrorizmi nuk duhet të nënvlerësohet është e vetëkuptueshme, por që duhet trajtuar si rrezik edhe kur nuk mbështetet nga faktet, është e kuptueshme. Kuptimi qëndron se *mundësia* për një sulm të mundshëm krijon legjitimitet për 'luftën ndaj terrorit' dhe mund të përdoret si një strategji pjellore për ripërtëritjen e pasigurisë dhe ankthit mbarëbotëror dhe nevojën për të marrë 'masat e jashtëzakonshme'⁴². Në kundërshtim me përshkrimin e rreziqeve që ndjellin përqendrimin e vëmendjes së shumicës, rreziqet më jetike që kërcënojnë shumicën dërrmuese të njerëzve anembanë botës janë shumë herë më urgjente dhe të ndryshme nga ato për të cilat krijohet përshtypja. Viktimat e shkaktuara nga luftërat apo aktet terroriste

janë të papërfillshme përballë shumicës dërrmuese të viktimave që shkaktohen nga dhuna e qëndrueshme strukturore dhe keq-qeverisja. Vetëm nga uria vdesin çdo ditë 100.000 njerëz dhe 852.000.000 janë të uritur. Më shumë se 6 milionë fëmijë në vit nuk arrijnë moshën pesëvjeçare nga mungesa e ushqimit të bollshëm⁴³. Pa përmendur këtu pasojat katastrofike të asimetrive dhe pabarazive globale në rritje, të padrejtësive strukturore, të shkatërrimit të mjedisit, sfida këto, që rrezikojnë vetë ekzistencën e jetës në tokë. Siguria dhe mirëqenia shoqërore janë dy anë të së njëjtës medalje.

Dyfish vrasës është përqendrimi i vëmendjes dhe shpenzimi i energjive në simptomat dhe jo në shkaqet nga burojnë rreziqet që kinse luftohen dhe që pikëllojnë ndërgjegjen e shumicës së njerëzve për domosdoshmërinë e kësaj lufte. Proporcionaliteti, si në interpretimin dhe përzgjedhjen e rreziqeve ashtu dhe në trajtimin e tyre është vendimtar për uljen e pasojave të 'sigurizimit' dhe të mënjanimin të pasojave të sfidave jetike për të gjithë njerëzit.

Shënime

1. Kuptimi i legjitimitetit është tepër i kontestueshëm dhe merr trajta dhe përmbajtje të shumanshme sa analizimi i saj, qoftë dhe sipërfaqësor, është larg qëllimit të këtij punimi. Këtu, legjitimiteti ka të bëjë me krijimin dhe brendësimin e bindjes tek njerëzit për nevojën dhe dobën e qenies së shtetit. Për një trajtim të zgjeruar shih: Tarifa, Fatos (1997) "The Quest for Legitimacy and the Withering Away of Utopia". *Social Forces*. Vol. 76, No. 2, p. 437-473. Gjithashtu: Hurd, Ian (1999) "Legitimacy and Authority in International Politics". *International Organization*. Vol. 53, No. 2, p. 379-408; Mulligan, Shane P. (2005) "The Uses of Legitimacy in International Relations". *Millennium: Journal of International Studies*. Vol. 34, No. 2, p. 349-375.

2. Edhe pse është e vetëkuptueshme, ka vend të ritheksohet se kjo përzgjedhje thjeshtëzuese detyrimisht bazohet mbi kriteret që mund të shihen edhe si arbitrare, prandaj është e udhës të bëhet e qartë qysh në fillim se një këndvështrim i tillë, nuk përbën veçse një interpretim të ndryshëm të së njëjtës gjë. Teoritë e marrëdhënive ndërkombëtare janë të nevojshme, por s'ka arsye pse të mbivlerësohen kur, vetëm për të përmendur një nga dështimet e tyre të radhës, nuk ishin të afta të parashikonin as fundosjen e Bashkimit Sovjetik dhe fundin e Luftës së Ftohtë, ngjarje ekzistenciale për rendin ndërkombëtar. Aftësia e kufizuar shpjeguese e teorisë tradicionale hapi një dritare mundësie për konsolidimin e rrymës së re konstruktiviste, që ka shumë degëzime dhe që nuk mund të ceken në këtë trajtim.

3. Për më tepër shih: Wendt, Alexander (1992) "Anarchy is what States Make of it: The Social Construction of Power Politics". *International Organization*, Vol. 46, No. 2, 391-425.

4. Për një përshkrim të mirë shih: Nye, Joseph (1988) 'Neorealism and Neoliberalism'. *World Politics*. Vol. 40, No. 2, p. 235-251. Për një analizë kritike të neorealizmit (përballë teorisë së sistemit botëror) shih: Wendt, Alexander (1987) 'The Agent-Structure Problem in International Relations Theory'. *International Organization*. Vol. 41, No. 3, p. 335-370.

5. Dilema e sigurisë është produkt i pasigurisë dhe papërcaktueshmërisë të përjetuar si të vërtetë. Sipas Wendt, dilema e sigurisë është '... a social structure composed of intersubjective understandings in which states are so distrustful that they make worst-case assumptions about

each others' intentions, and as result define their interests in self-help terms' (Wendt, 1995, 73). Në mungesë të informacionit të ndërsjellë ku sundon klima e mosbesimit dhe ankthit për qëllimet e shteteve përkatëse, një shtet që armatohet kërcënon shtetet e tjera dhe rrezikon një konflikt, si dhe çdo shtet që nuk armatohet, bëhet pre e shteteve që janë të armatosur dhe rrezikon gjithashtu një konflikt. Në një gjendje të tillë papërcaktueshmëri dhe mosbesimi, si armatosja ashtu dhe mos armatosja rrisin probabilitetin për konflikt.

6. Për më tepër shih: Wendt, Alexander (1994) "Collective identity formation and the international state". *American Political Science Review*, Vol. 88, No. 2, 384-396.

7. Për një apologji shih: Legro, Jeffrey W. & Moravcsik, Andrew (1999) 'Is Anybody Still a Realist?'. *International Security*, Vol. 24, No. 2, p. 5-55.

8. 'Constructivism is a structural theory of the international system that makes the following core claims: (1) states are the principal units of analysis for international political theory; (2) the key structure in the states system are intersubjective, rather than material; and (3) state identities and interests are in important part constructed by these social structures, rather than given exogenously to the system by human nature or domestic politics' (Wendt, 1994, 385).

9. Për më tepër shih: Weiner, Antje (2003) "Constructivism: The Limits of Bridging Gaps". *Journal of International Relations And Development*. Vol. 6, No. 3, p. 252-275. Ose: http://www.ciaonet.org/olj/jird/jird_sep03_wia01.pdf; Guzzini, Stefano (2005) "The Concept of Power: a Constructivist Analysis". *Millennium: Journal of International Studies*. Vol. 33, No. 3, p. 495-521.

10. Ky pohim nënkupton se mundësia e aktorëve për të dhënë kuptimin e 'saktë' të fakteve apo dukurive shoqërore varet nga aftësia apo kapacitetet e tyre për të ndarë një sistem kuptimesh të përbashkëta brenda një grupi të caktuar. Këto kapacitete pohojnë rolin e kontekstit të strukturës brenda të cilave krijohen identitetet, interesat dhe perceptimet. Rrjedhimisht 'gjërat' në vetvete s'kanë asnjë kuptim; bota materiale nuk mbart kuptim, por njerëzit ndërtojnë kuptimin e gjërave dhe të botës. Vetëveprimet që shihen si domethënëse në ndërveprimet shoqërore nuk mund të kuptohen pa kuptimin që ju jepet nga vetë njerëzit.

11. Për një kritikë shih: Desch, Michael C. (1998) "Culture Clash: Assessing the Importance of Ideas in Security Studies". *International*

Security. Vol. 23, No. 1, p. 141-170.

12. Për më tepër shih: Wendt, Alexander (1995) "Constructing International Politics". *International Security*, Vol. 20, No. 1, p. 71-81.

13. Për më tepër shih: Wendt, Alexander (1992) "Anarchy is what States Make of it: The Social Construction of Power Politics". *International Organization*, Vol. 46, No. 2, 391-425.

14. Për më tepër shih: Hopf, Ted (1998) "The Promise of Constructivism in International Relations Theory" *International Security*. Vol. 23, No. 1, p. 171-200.

15. Për shembull, identiteti i shteteve anëtarëve të NATO-s është i volitshëm për të mundësuar qenien e një organizate të tillë. Identiteti i pafavorshëm përjashton të njëjtën mundësi në Azi. Shpjegimet (neo)realiste si një aleance kundër rreziqeve të përbashkëta janë të pamjaftueshme. Gjithashtu perceptimi i identitetit të përbashkët ndikoi pozitivisht në ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë, dhe nuk ndihmoi të merren të tilla veprime për të ndaluar gjenocidin në Ruandë. Për më tepër shih: Hemmer, Christopher & Katzenstein Peter J. (2002) "Why Is There No NATO in Asia? Collective Identity, Regionalism, and the Origins of Multilateralism". *International Organization*. Vol. 56, No. 3, p. 575-607.

16. "[...] self-help and power politics do not follow either logically or causally from anarchy and that if today we find ourselves in a self-help world, this is due to process, not structure. There is no "logic" of anarchy apart from the practices that create and instantiate one structure of identities and interests rather than another; structure has no existence or causal power apart from process. Self-help and power politics are institutions, not essential features of anarchy. *Anarchy is what states make of it* (Wendt, 1992, 394-395).

17. Për një kritikë shih: Copeland, Dale C. (2000) "The Constructivist Challenge to Structural Realism". *International Security*. Vol. 25, No. 2, p. 187-212.

18. Për një përshkrim të agresiv realist shih: Mearsheimer, John J. (1994-1995) 'The False Promise of International Institutions'. *International Security*, Vol. 19, No. 3, p. 5-49. Për kritika të argumentuara shih: Wendt, Alexander (1995) "Constructing International Politics". *International Security*, Vol. 20, No. 1, p. 71-81; Ruggie, John Gerard (1995) 'The False Promise of Realism'. *International Security*. Vol. 20, No. 3, p. 62-70; Kupchan, Charles A. & Kupchan, Clifford A. (1995) 'The Promise of Collective Security'. *International Security*, Vol. 20, No. 1, p. 52-61.

19. Parashikimi vetëkonfirmues, *Self-fulfilling prophecy*, është një nga përshkrimet e sociologut dhe ekonomistit amerikan Robert K. Merton, si një përcaktim apo gjykim fillestar i stisur i një gjendjeje të caktuar e cila shkakton përjetimin e një sjelljeje të re që shndërron konceptin fillestar të rremë të bëhet i vërtetë.

20. Për më tepër shih: Huntington, Samuel P. (1993) "The Clash of Civilizations?". *Foreign Affairs*. Vol. 72, No. 3, p. 22-50.

21. Guzzini, Stefano (2005) "The Concept of Power: a Constructivist Analysis". *Millennium: Journal of International Studies*. Vol. 33, No. 3, p. 495-521.

22. Për më tepër shih: Barry Buzan (1991) *People, States and Fear*. An agenda for international security studies in the post-cold war era. New York, Harvester Wheatsheal, 2nd ed., 393 p.

23. Buzan (1991, 16-17) citon dymbëdhjetë përkufizime të sigurisë, për të dalë më pas me një të tjetër si: 'In the case of security, the discussion is about the pursuit of freedom from threat. When this discussion is in the context of the international system, security is about the ability of states and societies to maintain their independent identity and their functional integrity' (Buzan, 1991, 18). Por se çfarë përbën një 'rrezik', nga kush kanë ky rrezik, për çfarë vlerash, real apo i perceptuar, mbetet ende për tu përcaktuar.

24. Për më tepër shih: Huysmans, Jef (1998) 'Security! What Do You Mean? From Concept to Thick Signifier', *European Journal of International Relations*, Vol. 4, No. 2, p. 226-255.

25. Në një mënyrë të ngjashme e përshkruan dhe Buzan: 'In seeking security, state and society are sometimes in harmony with each other times opposed. Its bottom line is about survival, but it also reasonably includes a substantial range of concerns about the conditions of exis-

tence' (Buzan, 1991, 19).

26. Për më tepër shih: Wæver, Ole "Securitization and Desecuritization". In: Lipschutz, Ronnie D. (ed.) (1998) *On Security*. New York, Columbia University Press, <http://www.ciaonet.org/frame/wpsfrm.html>

27. Përshkrimi i 'sigurisë' si një shprehje gjuhësore ka të bëjë me identifikimin, nëpërmjet diskutit, të kushteve lejuese të cilat bëjnë të mundur justifikimin e masave të caktuara për të mbrojtur sigurinë (e shtetit) kundrejt një rreziku që paraqitet si i qenë: 'What then is security? With the help of language theory, we can regard "security" as a *speech act*. In this usage, security is not of interest as a sign that refers to something more real; the utterance *itself* is the act. By saying it, something is done (as in betting, giving a promise, naming a ship). By uttering "security," a state-representative moves a particular development into a specific area, and thereby claims a special right to use whatever means are necessary to block it' (Wæver, 1998).

28. Për një kritikë shih: Balzacq, Thierry (2003-2004) 'Qu'est-ce que la sécurité nationale?'. *La revue internationale et stratégique*, No. 52, 17 p.

29. Lipschutz, Ronnie D. "Negotiating the Boundaries of Difference and Security at Millennium's End". In: Lipschutz, Ronnie D. (ed.) (1998) *On Security*. New York, Columbia University Press, <http://www.ciaonet.org/frame/wpsfrm.html>

30. Shprehje e huazuar nga teorema klasike e William I. Thomas.

31. Për më tepër shih: Dillon, Michael (1996) *The Politics of Security: Towards a Philosophy of Continental Thought*. London, Routledge, 252 p.

32. Për më tepër shih: Campbell, David (1998) *Writing Security: United States Foreign Policy and the Politics of Identity*. Minneapolis, University of Minnesota Press, 312 p.

33. Për më tepër shih: Mutimer, David (2000) *The Weapons State: Proliferation and the Framing of Security*. London, Lynne Rienner Publishers, 221 p.

34. 'The definition of difference is a requirement built into the logic of identity, and the construction of otherness is a temptation that readily insinuates itself into that logic – and more than a temptation: a temptation because it is constantly at work and because there may be political ways to fend it off or to reduce its power; more than a temptations because it typically moves below the thresholds of conscious reflection and because every attempt to come to terms with it encounters stubborn obstacles built into the logic of identity and the structural imperatives of social organization' (Mutimer, 2000, 81).

35. Për më tepër shih: Mann, James (2004) *Rise of the Vulcans: The History of Bush's War Cabinet*. New York, Viking, 448 p.

36. Për më tepër shih: Nye, Joseph S (2006) 'Round by Round: Winners and Losers in the Post-9/11 Era'. *The Daily Star* (September 6).

37. Për më tepër shih: Fukuyama, Francis (2006) 'After Neoliberalism'. *New York Times* (February 19).

38. Behnke, Andreas (2000) 'Inscriptions of Imperial Order: NATO's Mediterranean Initiative'. *The International Journal of Peace Studies*. Vol. 5, No. 1; http://www.gmu.edu/academic/ijps/vol5_1/behnke.htm

39. Për më tepër shih: Huysmans, Jef (2000) 'The European Union and the Securitization of Migration'. *Journal of Common Market Studies*. Vol. 38, No. 5, p. 751-777.

40. Për më tepër shih: Taylor, Kathleen (2004) *Brainwashing. The science of thought control*. Calerendon, Oxford, University Press, 324 p.

41. Për më shumë detaje shih: Marshall, Monty G. & Gurr, Ted Robert (2005) "Peace and conflict 2005: a global survey of armed conflicts, self-determination movements, and democracy". Center for International Development & Conflict Management, 93 p.; <http://www.cidcm.umd.edu/inscr/PC05print.pdf>. Për më tepër shih: Mack, Andrew (ed.) (2005) "Human Security Report 2005. War and Peace in the 21 Century". Oxford, University Press, 166 p.; <http://www.humansecurityreport.info/content/view/28/63>

42. Për më tepër shih: Arkin, William M. (2006) "The continuing misuses of fear". *Bulletin of the Atomic Scientists*. Vol. 62, No. 5, p. 42-45. Gjithashtu: http://www.thebulletin.org/article.php?art_ofn=so06arkin

43. Note by the Secretary-General transmitting the interim report of the Special Rapporteur on the right to food, 1 September 2006, <http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N06/486/28/PDF/N0648628.pdf?OpenElement>